

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA E LEJEVE TE DREJTIMIT

PYETËSOR PËR DREJTUESIT E AUTOMJETEVE PËR TRANSPORT UDHETARESH ME TAKSI



TIRANË 2014

HYRJE

Pyetësori teorik për drejtuesit e mjeteve Taksi” është hartuar mbi bazen e programit zyrtar të hartuar nga DPSHTRR-ja, për kontrollin e njohurive teorike të aplikantëve për drejtues të mjeteve Taksi, për transport udhëtaresh.

Pyetësori është përgatitur nga një grup specialistësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Si bazë për hartimin e këtij pyetësori ka shërbyer Ligji Nr.8378 dt.22.07.1998 ‘‘Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë’’. i ndryshuar, Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 ‘‘Për Transportet Rrugore’’, i ndryshuar, VKM Nr.153 dt.07.04.2000 ‘‘Për miratimin e Rregullorës për Zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë’’ i ndryshuar, Udhëzimi i MPPTT Nr.1649, datë 16/08/1999 ‘‘Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtareve’’, i ndryshuar, Udhëzimi i MPPTT, nr. 15, datë 24/07/2007 ‘‘Për kriteret dhe procedurat e leshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin tokësor’’, i ndryshuar, Udhëzimi i MPPTT, nr. 12, datë 19/07/2007 ‘‘Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e licencave, bllokut të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi’’ dhe Udhëzimi i MPPTT, nr. 1726/3, datë 21/04/2008 ‘‘Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi’’.

Pyetësori përmban njohuritë e detyrueshme të karakterit të përgjithshëm dhe të veçantë që duhet të ketë çdo drejtues mjeti taksi. Këtu përfshihen përcaktime kryesore në fushën e transportit rrugor të udhëtareve, normat e sjelljes së drejtuesit të mjetit taksi gjatë udhëtimit, zbatimi i normave ligjore për kryerjen e shërbimit taksi, sinjalet rrugore të paralajmërimeve dhe perzgjedhjes, dokumentacioni i nevojshëm, etika e drejtuesit të mjetit taksi dhe komunikimi me udhëtarët, veprimet në raste aksidentesh, njohuri mbi ndihmen e parë në raste aksidentesh dhe sanksionet administrative që jepen në rastë shkeljesh nga drejtuesit e mjeteve të shërbimit taksi.

KAPITULLI I

LIÇENSIMI. KRITERET BAZE TE LIÇENSIMIT, DOKUMENTACIONI, AFATET DHE VLEFSHMERIA E TYRE.

Pyetësi 1	Shërbim taksi, është
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërbim publik i licencuar 2. shërbim që siguron një transport të mënjeherëshëm e të drejtperdrejtë të udhëtarëve dhe bagazheve 3. shërbim që kryhet vetëm me mjete origjinale të prodhuara për transport udhëtarësh
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërbim publik që mund të kryhet në linjë të rregullt 2. shërbim publik që mund të kryhet me autobus 3. shërbim linjë me stacione të caktuara më pare 4. shërbim publik i që mund të kryhet edhe pa licencë

Pyetësi 2	Për tu paisur me licencë shërbimi taksi, për transport udhëtarësh, krahas të tjerave duhet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të jesh subjekt fizik ose juridik 2. të disponosh mjete të prodhimit origjinal për transport udhëtarësh 3. që çdo mjet i shërbimit të jetë i pajisur me aktin e vleresimit teknik, nga organet përkatëse 4. që drejtuesit e mjeteve, të jenë të paisur me lejedrejtimi të kategorisë “D” 5. që drejtuesit e mjeteve, të jenë të paisur me “Dëshmi Taksisti” 6. që automjetet taksi, të jenë të pajisura me targa të veçanta 7. që automjetet taksi, të jenë me ngjyrën e kërkuar nga bashkia liçensuese.
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të jesh pa tjetër subjekt juridik 2. të jesh vetëm person fizik 3. që drejtuesit e mjeteve, të jenë të paisur të paktën me lejedrejtimi të kategorisë “B” 4. që drejtuesit e mjeteve, të jenë të paisur të pakten me lejedrejtimi të kategorisë “C” 5. që drejtuesit e mjeteve, të jenë të paisur me “Dëshminë” e instruktorit të praktikës 6. drejtuesit e mjeteve të jenë të pajisur me Çertifikatën e Aftesimit Profesional të tipit KC.

Pyetësi 3	Gjatë kryerjes së veprimtarisë së transportit drejtuesi i mjetit taksi duhet të mbajë me vete
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. liçencën për ushtrimin e veprimtarisë së transportit “Taksi” 2. aktin e vleresimit teknik të mjetit 3. lejen e drejtimit 4. Dëshminë e Taksistit 5. lejen e qarkullimit të automjetit 6. dokumentin e taksës së vjetërsisë të mjeteve të përdorura (vjetore)

	<ol style="list-style-type: none"> 7. dokumentin e sigurimit të detyrueshëm të mjetit, ndaj palëve të treta 8. bllokun e faturimit.
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. çertifikatën e transportit të automjetit 2. çertifikatën e pronësisë së automjetit. 3. autorizimin të lëshuar nga Bashkia përkatëse 4. vertetimin e lëshuar nga Keshilli bashkiak 5. autorizimin e Këshillit të Qarkut

Pyetësi 4	Personi fizik ose juridik, që kërkon të licençohet për kryerjen e transportit të udhëtareve me taksi duhet të provojë se ka
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kompetencën profesionale 2. reputacionin e mirë 3. gjendje të përshtatshme financiare
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. në pronësi, të paktën dy automje për transport udhëtarësh me 4+1 vënde 2. në pronësi një mjet për transport udhëtarësh me 4+1 vënde, me vjetërsi jo më shumë se dy vjet nga data e prodhimit 3. një përvojë pune në fushën e transportit jo më pak se 5 vjet

Pyetësi 5	Licenca për veprimtarinë e transportit të udhëtareve me taksi, humbet vlerën kur
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. vdes mbajtësi i saj 2. humb zotësinë për të vepruar mbajtësi i saj 3. mbaron afati i dhënies së saj
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. deklarohet e humbur 2. deklarohet e vjedhur 3. është bërë e pa lexueshme për shkak të dëmtimit

Pyetësi 6	Licenca për veprimtarinë e transportit të udhëtareve me taksi, hiqet nga organi që e ka lëshuar atë kur
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kërkohet nga mbajtësi i saj 2. veprimtaria nuk fillon në kohën e përcaktuar në të 3. mbajtësi i saj nuk plotëson kushtin e reputacionit të mirë 4. mbajtësi i saj nuk plotëson kushtin e besueshmërisë financiare 5. mbajtësi i saj nuk plotëson kushtin e kompetencës profesionale 6. mbajtësi i saj nuk zotëron mjetet, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar 7. provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë në të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. drejtuesi i mjetit dënohet me gjobë për shkelje të normave të sjelljes së kodit Rrugor 2. dëmtohet licenca 3. ka humbur licenca 4. është vjedhur licenca

Pyetësori 7	Afati i vlefshmërisë
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. së licencës së shërbimit taksi, është pesë vjet, kur lëshohet për herë të parë 2. së licencës së shërbimit taksi, është pesë vjet, kur rinovohet, me kusht që subjekti të ketë plotësuar detyrimet ligjore 3. së dëshmisë së taksistit është dy vjet, kur lëshohet për herë të parë 4. së dëshmisë së taksistit është dy vjet, kur rinovohet
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. së licencës së shërbimit taksi, është një vit, kur lëshohet për herë të parë 2. së licencës së shërbimit taksi, është dy vjet, kur rinovohet, me kusht që subjekti të ketë plotësuar detyrimet ligjore 3. së dëshmisë së taksistit është një vit, kur lëshohet për herë të parë 4. së dëshmisë së taksistit është pesë vjet, kur rinovohet

Pyetësori 8	Licencë rezervë për shërbimin taksi lëshohet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur dëmtohet rëndë licenca 2. kur deklarohet e humbur licenca 3. kur deklarohet e vjedhur licenca
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. për të njejtin mjet, por, kur udhëton jashtë rrethit të regjistrimit 2. për mjetet me (8+1) vënde në shërbim linje rrethqytetëse 3. kur licenca është terhequr nga organi i policisë

MENYRA E ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT TAKSI.

Pyetësori 9	Vendqëndrimet e taksive, për transport udhëtarësh me taksi, përcaktohen nga
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. këshilli bashkiak/komunal, për shërbimin në (teritorin që ka në juridiksion) qytet 2. drejtorja e aeroportit, në aeroporte 3. drejtorja e hekurudhave, në stacionet e trenave 4. drejtorja e portit, në porte 5. agjensitë përkatëse, për shërbimin ndërqytetës 6. agjensitë përkatëse, për shërbimin ndërkombëtar.
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kryetari i bashkisë, në qytete 2. kryetari i qarkut, në komuna 3. kryetari i komunës, në komuna 4. kryetari i keshillit të qarkut në porte 5. kryetari i bashkisë përkatëse në aeroporte.

Pyetësori 10	Liçensa, për shërbimin taksi, lëshohet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. nga Kryetari bashkisë përkatëse, kur veprimtaria kryhet në qytet 2. nga Kryetari i komunës përkatëse, kur veprimtaria kryhet në komunë 3. nga Kryetari bashkisë kur veprimtaria kryhet në porte ose aeroporte që janë nën juridiksionin e kësaj bashkie

<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur veprimtaria kryhet në linjë të rregullt brenda qytetit 2. kur veprimtaria kryhet në linjë të rregullt rrethqytetes 3. kur veprimtaria kryhet në linjë të rrëgull ndërqytetëse 4. kur veprimtaria kryhet në linje të rregullt midis dy komunave 5. kur veprimtaria kryhet në linje të rregullt midis dy rretheve
-----------------------------	--

Pyetësori 11	Këshilli bashkiak/komunal përcakton
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. mënyren e organizimit të shërbimit taksi nën juridiksionin e vet 2. mënyren e funksionimit të shërbimit taksi nën juridiksionin e vet. 3. nivelet e diferencuara të çmimeve brenda juridiksionit të vet, por në përputhje me udhezimin e MTI + MF.
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. nivelin dysheme të tarifave të shërbimit taksi 2. numrin maksimal të taksive në shkallë rrethi 3. numrin e taksive në komuna të rrethit 4. rregullat për kërkesa të veçanta për taksitë 5. kushtet për kërkesa të veçanta për taksitë 6. rregullat për zbatimin e tarifave dhe të çmimeve të taksive

Pyetësori 12	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës përcakton
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. numrin maksimal të taksive në shkallë vendi 2. numrin maksimal të taksive në shkallë rrethi 3. rregullat për zbatimin e tarifave dhe të çmimeve 4. kushtet për kërkesa të veçanta për mjetet taksi 5. numrin maksimal të taksive me (8 +1) vënde
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. nivelin dysheme të tarifave për të gjitha llojet e taksive 2. vëndqëndrimet e taksive në shkallë qarku 3. llojet e taksive që mund të shërbejnë jashtë rrethit të regjistrimit 4. modelin e taksimetrit për taksitë

Pyetësori 13	Numri maksimal i taksive,
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. është i pa kufizuar në shkallë vendi, për mjetet me (4+1) vënde 2. është i pa kufizuar në shkallë rrethi, për mjetet me (4+1) vënde 3. është i pa kufizuar në shkallë qarku, për mjetet me (4+1) vënde
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. një taksi për çdo 1000 banorë, për mje të me (4+1) vënde 2. një taksi për çdo 2000 banorë, për mje të me (4+1) vënde 3. një taksi për çdo 2000 banorë, për mje të me (8+1) vënde

KUSHTET E VEÇANTA QË DUHET TË PLOTESOJNË AUTOMJETET E SHERBIMIT TAKSI.

Pyetësori 14	Automjetet e shërbimit "Taksi" për transport udhëtarësh,
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, për një udhëtim të sigurtë 2. duhet të jenë të pajisura nga organet përkatëse, me aktin e vleresimit teknik 3. duhet të kenë numrin e vëndeve të ulura jo më pak se katër dhe jo më

	<p>shumë tetë, përveç drejtuesit</p> <ol style="list-style-type: none"> duhet të jenë të pajisura me jo më pak se katër dyer funksionale, pa përfshirë deren e bagazhit, për autoveturat me (4+1) vende duhet të jenë të pajisura me jo më pak se tre dyer funksionale, për autoveturat me (8+1) vende.
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> duhet të kenë masë maksimale, të autorizuar, jo më shumë se 3,5 tonë mund të jenë edhe kamjonçina, të përshtatura për transport udhëtarësh mund të jenë me tre dyer, përfshirë edhe atë të bagazhit, për autoveturat me (4+1) vende
Pyetësi 15	Automjetet e shërbimit "Taksi" për transport udhëtarësh,
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> duhet të kenë ngjyrën e përcaktuar nga Bashkia që lëshon licencën kur ju përkasin shoqërive transportuese, në mesin e dyerëve, kanë të shënuar, emrin dhe numrin e telefonit të shoqërisë duhet që mbi pjesën e sipërme, në krah të drejtuesit të automjetit, të vendosin një tabelë të ndriçuar, me fushë të verdhë, me mbishkrimin "Taksi" nuk lejohet të vendosin me fiksion magnetik ose pneumatik në pjesën e sipërme të automjetit tabelën "Taksi" duhet të jenë të pajisura me kutinë e ndihmes së shpejtë duhet të jenë të pajisura me trekëndëshin e levizëshëm të rrezikut në kushtet e udhëtimit me akull dhe borë në rrugë, duhet të jenë të pajisura me zinxhire, të pakten për një rrotë duhet të kenë në gjendje funksionale, sistemin e ngrohjes duhet të kenë në gjendje funksionale, sistemin e ventilimit duhet të kenë në gjendje funksionale, sistemin e ajrit të kondencionuar
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> duhet ti kenë detyrimisht rrotat e para aktive duhet të jenë të pajisura detyrimisht me dy trasmissionë nuk duhet të kenë vjetërsi më shumë se tre vjet, nga data e prodhimit të fabrikës duhet detyrimisht të jenë me motor dizel duhet detyrimisht të jenë me motor benzine

Pyetësi 16	Kontrolli teknik i mjeteve taksi
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> është kontroll i detyruar edhe për mjetet e këtij shërbimi që kanë 4+1 vende verifikon nëse mjete garantojnë sigurinë dhe qetësinë në qarkullim si dhe që ndotja e tyre nuk i kalon kufijtë e caktuar kryhet në qendra të specializuara të autorizuar nga MTI në të gjitha rastet është periodik me period 6 mujore është i detyruar edhe për mjetet e këtij shërbimi me 8+1 vende
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> kryhet një herë në vit për të gjitha mjetet e transportit të udhëtarëve kryhet një herë në vit vetëm për mjetet e shërbimit taksi me 4+1 vende kryhet një herë në 6 muaj vetëm për mjetet "Taksi" me 8+1 vende. bëhet vetëm për përcaktimin e nivelit të ndotjeve të ambientit nga zhurmat dhe gazrat që çlirohen nga motomjetet dhe automjetet.

NORMAT E SJELLJES GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISE SË SHERBIMIT TAKSI.

Pyetësori 17	Drejtuesit e mjeteve të shërbimit taksi duhet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mbajnë pastër në çdo kohë mjetin ose mjetet 2. të kenë dhe të njohin hartën e qytetit, ku kryejnë aktivitetin kryesor 3. të dinë adresat kryesore të institucioneve publike 4. të dinë adresat e hoteleve 5. të dinë adresat e qendrave shëndetësore 6. të dinë adresat e qendrave turistike 7. kenë njohuri minimale për një gjuhë të huaj ndërkombëtare 8. të dinë adresat e qendrave muzeale
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të dinë të pakten dy gjuhë të huaja 2. të jenë të veshur me kostum 3. të jenë me moshë mbi 30 vjeç 4. të mos ndalojnë kur janë të përfshirë në aksident.

Pyetësori 18	Drejtuesi i mjetit taksi duhet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos kundërshtojë pajtimtarët, përveç rasteve që veprimet e tyre bien në kundërshtim me normat ligjore 2. të mos bëjë faturim në kundërshtim me ligjin 3. të ndërpresë udhëtimin kur e kërkon udhëtari duke qëndruar në anë të rrugës për jo më shumë se 15 minuta, përveç shkaqeve të rënda 4. të shërbejë në rrugën më të shkurtër, me përjashtim të rasteve kur udhëtari zgjedh një rrugë tjetër 5. të ndërpresë funksionimin e taksimetrit kur ndalon ose devijon rrugën për shkak furnizimi me karburant ose servisi të detyrueshëm 6. të jetë i sjellshëm, i gatshëm, i shpejtë dhe me veshje të pranueshme 7. të dorëzojë në polici ose tek poseduesi, sendet e harruara në automjet 8. të vendosë në krah të taksimetrit në vend të dukshëm licencën
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos kundërshtojë udhëtarët, kur ata duan të transportojnë lëndë toksike 2. të mos kundërshtojë udhëtarët, kur ata duan të transportojnë lëndë plasëse 3. të mos kundërshtojë udhëtarët, kur ata janë të dehur dhe nuk shoqërohen nga një i afërm i tyre 4. të mos kundërshtoj kur numri i pajtimtarëve është më i madh se numri i vendeve të automjetit 5. të dëmshperblejë objektet e dëmtuara të udhëtarëve, për shkak të forcave madhore.

Pyetësori 19	Drejtuesit e mjeteve taksi, në vendqëndrimet e taksive duhet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të radhiten sipas kohës së ardhjes së tyre 2. të mos bëjnë seleksionim udhëtarësh në vendprirje me përjashtim kur në rradhët e tyre ka invalidë, të verbër, të sëmurë, gra shtatëzëna, pavarisht nga radha e udhëtarëve që presin 3. të qëndrojnë në automjet ose pranë tyre kur janë të parët ose të dytët

	në radhë
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> të bëjnë seleksionim udhëtarësh, mbi bazën e njohjes të marrin pajtimtare jashtë radhe të mos japin ndihmën në sistemimin e bagazheve të pajtimtarëve

Pyetësi 20	Drejtuesi i mjetit taksi, kërkon parapagim nga pajtimtaret,
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> kur vihet në dispozicion të personave zyrtar kur vihet në dispozicion të personave privat, për raste vdekje kur vihet në dispozicion të personave privat, për raste dasmash kur kërkohet rezervimi i taksisë kur kërkohet rezervimi i taksisë për udhëtim jashtë rrethit të regjistrimit
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> kur udhëton me më shumë se një pajtimtar kur në ecje e siper merr një udhëtar kur transporton nga vëndqendrimi i taksive, udhëtare për në stacionin e trenit. kur transporton nga vëndqendrimi i taksive, udhëtarë për tek stacioni i autobusëve të linjave ndërqytetëse.

Pyetësi 21	Gjatë udhëtimit me taksi, udhëtari duhet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> të mos pengojë me lëvizjet e tij drejtuesin e mjetit të mos hipi ose të zbresi kur mjete është në levizje të mos pijë duhan pa aprovimin e drejtuesit të mjetit të mos hapë dritaret pa aprovimin e drejtuesit të mjetit të mos bisedojë me drejtuesin e mjetit për tema të papërshtatshme. të mos ngacmojë asgjë që sjell pasoja në funksionimin e mjetit
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> të jetë detyrimisht i veshur me kostum të mos i kerkojë në asnjë rast drejtuesit të ndalojë mjetin të refuzojë kerkesen e policisë për të treguar dokumentin e identitetit të refuzojë kerkesen e organeve të kontrollit për faturen e udhëtimit.

Pyetësi 22	Drejtuesi i mjetit taksi duhet :
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> të ndihmojë udhëtarët në ngarkim – shkarkimin e bagazheve të jetë i gatshëm dhe i shpejtë në veprime të demonstrojë sjellje të hijëshme me udhëtarët të ndalojë mjetin kur është i përfshirë në një aksident të ndihmojë të dëmtuarit në raste aksidentesh edhe nëse nuk është i përfshirë në aksident të transportojë të aksidentuarit edhe nëse nuk është i përfshirë vet në aksident.
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> që gjatë qarkullimit në qytet, të mos vendosë rripin e sigurimit të mos transportojë persona të dehur, edhe nëse ato shoqërohen nga një i afërm i tij të mos bëjë seleksionim udhëtarësh në vëndqendrim, edhe kur në radhët e tyre ka të sëmurë të mos bëjë seleksionim udhëtarësh në vëndqendrim, edhe kur në radhët e tyre ka të verbër

	<ol style="list-style-type: none"> 5. të mos bëjë seleksionim udhëtarësh në vendqendrim, edhe kur në radhët e tyre ka gra shtatëzëna 6. të mos bëjë seleksionim udhëtarësh në vendqendrim, edhe kur në radhët e tyre ka invalidë
--	--

Pyetësi 23	Drejtuesit të mjetit taksi i lejohet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të marrë udhëtarë, në stacionet e linjave të rregullta rrethqytetëse, me qëllim kryerjen e shërbimit brenda qytetit 2. të marrë udhëtarë, në stacionet e linjave të rregullta ndërqytetëse, me qëllim kryerjen e shërbimit brenda qytetit 3. të lejë udhëtarë, në stacionet e linjave të rregullta rrethqytetëse 4. të lejë udhëtarë në stacionet e linjave të rregullta ndërqytetëse, me qëllim kryerjen e shërbimit brenda qytetit
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. marrja e udhëtareve në stacionet e autobusëve të linjave qytetëse 2. marrja e udhëtareve në stacionet e linjave të rregullta rrethqytetëse, për të kryer shërbim linje 3. marrja e udhëtareve në stacionet e autobusëve të linjave ndërqytetëse, për të kryer shërbim linje

Pyetësi 24	Gjatë kryerjes së shërbimit të transportit taksi, është i ndaluar transporti i udhëtarëve
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. në linjë të rregullt qytetëse të autobusëve 2. në linje të rregullt rrethqytetëse, të autobusëve 3. në linjë të rregullt rrethqytetëse, midis dy bashkive të njejtit rreth 4. në linjë të rregullt rrethqytetëse midis dy komunave të një rrethi 5. në linjë të rregullt ndërqytetëse, midis dy bashkive të rretheve të ndryshme, të të njejtit qark 6. në linjë të rregullt midis dy bashkive qendër të rretheve të ndryshme
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. për në stacionet e trenit 2. për në sheshet e trageteve 3. për në терминалет e autobusëve, ndërqytetës 4. për në spitale 5. për në portet detare. 6. për në pikat turistike

KRYERJA E SHËRBIMIT TAKSI, JASHTË RRETHIT TË REGJISTRIMIT.

Pyetësi 25	Shërbimit taksi, jashtë rrethit të regjistrimit
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. ju ofrohet udhëtarëve që hipin në rrethin e regjistrimit të mjetit taksi 2. ju ofrohet udhëtarëve në kthim vetëm kur kanë prenotuar ose rezervuar më parë, në vajtje, dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të mjetit taksi 3. kryhet vetëm nëpërmjet agjensive të licencuara për “Agjensi transporti udhëtarësh me taksi brenda vendit”
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. në kthim, mund ti ofrohet çdo udhëtar që e kërkon këtë shërbim 2. në kthim, mund ti ofrohet çdo udhëtar, por me kushtin që të merret në

	<p>stacionet e taksive</p> <p>3. në kthim, mund tu ofrohet udhëtarëve, vetëm në rastin kur mjete taksive ka levizur bosh nga rrethi i regjistrimit për në rrethin tjetër, i prenotuar me telefon</p>
--	--

Pyetësi 26	Kur mjete taksive kryejnë shërbim transporti, jashtë rrethit të regjistrimit,
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. pika e nisjes, duhet të jetë brenda juridiksionit të bashkisë/komunës ku është licencuar 2. pailet me një dokument udhëtimit, nga një agjensi e licencuar për transport udhëtarësh 3. në dokumentin e udhëtimit duhet të ketë të regjistruar edhe numrat e identifikimit të udhëtarëve.
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e nevojshme të kryejnë veprime nëpërmjet agjensive të licencuara për transport udhëtarësh 2. nuk është e nevojshme të pailet me dokument udhëtimit nga një agjensi e licencuar. 3. në dokumentin e udhëtimit nuk shënohen të dhëna mbi identitetin e udhëtarëve.

ÇMIMET DHE TARIFAT NË SHËRBIMIN TAKSI DHE TAKSIMETRI.

Pyetësi 27	Si rregull i përgjithshëm, niveli dyshe, i tarifave për taksive, duhet të jetë
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. jo më i vogël se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus, në linjat e rregullta qytetëse 2. jo më i vogël se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus, në linjat e rregullta rrethqytetëse 3. jo më i vogël se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus, në linjat e rregullta ndërqytetëse
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. më i vogël se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus, në linjat e rregullta qytetëse 2. më i vogël se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus, në linjat e rregullta rrethqytetëse 3. më i vogël se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus, në linjat e rregullta ndërqytetëse

Pyetësi 28	Taksimetri i vendosur në mjete taksive duhet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të jetë në gjendje pune 2. të jetë i plumbosur 3. të plotësojë standartet e miratuara 4. të jetë i vendosur në një pozicion të dukshëm nga udhëtarët 5. të jetë i pajisur me faturdhënie për udhëtarët
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ketë karakteristikat që përcaktojnë bashkia që lëshon licencën 2. të ketë karakteristikat që përcaktojnë DPSHTRR-ja 3. të ketë karakteristikat që përcaktojnë nga MTI-ja

	<ol style="list-style-type: none"> 4. të kolaudohet nga DPSHTRR-ja 5. të kolaudohet nga zyra e tatim – taksave të rrethit
--	---

Pyetësori 29	Funksionimi i taksimetrit ndërpritet kur :
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. mjeti ndalon 2. mjeti devijon rrugë për shkaqe furnizimi 3. mjeti devijon rrugë për servis të domosdoshem 4. mjeti në kthim është bosh (pa udhëtarë)
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. mjeti është i prenotuar 2. mjeti leviz jashtë rrethit të regjistrimit 3. mjeti është me(8+1)vende 4. mjeti është në kthim nga një rreth tjetër me të njejtët udhëtarë që kanë hipur në vajtje

Pyetësori 30	Njësi të matëse të miratuar për taksimetrat janë :
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. metri dhe kilometri, për distancën 2. sekondi, minuti dhe ora, për kohën 3. leku, si monedhë e vëndase
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. milimetri dhe centimetri, për distancën 2. dita, për kohën 3. euro dhe dollari, për monedhën


Pyetësori 31	Pagesa për shërbimin taksii,
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. llogaritet për të gjithë numrin e vendeve të saj pavarësisht nga numri i udhëtarëve, kur udhëtarët janë marrë në vendin e nisjes 2. llogaritet për një udhëtarë kur mjeti taksi gjatë kthimit nga një rreth tjetër, merr udhëtarë në rrethin e regjistrimit 3. për dy fëmijëve nën moshën 12 vjeç është baraz me një udhëtar të rritur 4. për një fëmijë nën moshën 12 vjeç është me vlerë zero (nuk paguhet) 5. llogaritet 10 lekë, për 25 kg peshë të bagazheve të para, dhe maksimumi 50 lekë për shtesen mbi 25 kg
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. llogaritet për çdo udhëtar në nisje 2. për një fëmijë nën 12 vjeç, është sa gjysma e çmimit të një të rrituri 3. është 25 lekë, për çdo 10 kg peshë bagazhi


Pyetësori 32	Nëse udhëtimi ndërpritet, jo për faj të udhëtarëve, drejtuesi i mjetit detyrohet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të sigurojë kthimin e udhëtarëve në vendnisje pa pagesë 2. të sigurojë një mjet tjetër për vijimin e udhëtimit për në destinacion 3. të njoftojë, drejtuesin e subjektit, për zëvendësim mjeti, kur mjeti transportues ka pësuar defekt
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të sigurojë kthimin e udhëtarëve në vendnisje, me pagesë 2. të njoftojë pajtimtaret, për të vijuar udhëtimin e tyre me mjete të rastit 3. të njoftojë organet e kontrollit në rrugë

KAPITULLI II


SINJALE RRUGORE


SINJALET PARALAJMERUESE DHE PERZGJEDHJES

166	
	
PARALAJMËRIM I NJË KRYQËZIMI URBAN	
Pyetësori 33	Sinjali nr.166
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron një kryqëzim urban (në një zonë të banuar) 2. tregon vendet që mund të arrihen nga ky kryqëzim 3. paralajmëron që duke u kthyer djathtas, mund të arrijmë në qendër të qytetit 4. paralajmëron që duke u kthyer djathtas, mund të arrijmë stacionin e trenit 5. tregon që duhet të vazhdojmë lëvizjen drejt për të dalë nga zona e banuar 6. tregon që duhet të vazhdojmë lëvizjen drejt për të arritur në një qendër tjetër të banuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal kryqëzimi në një rrugë interurbane (ndërqytetëse) 2. vendoset vetëm në rrugë urbane (qytetëse) me dy ose më shumë korsi për çdo sens lëvizjeje 3. paralajmëron afrimin e disa kryqëzimeve njëri pas tjetrit 4. tregon rrugë urbane me një sens lëvizje

167	
	
PARALAJMËRIM I KRYQËZIMEVE URBANE TË NJËPASNJËSHME	
Pyetësori 34	Sinjali nr 167
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është paralajmërim i afrimit të kryqëzimeve urban (qytetës) 2. në kryqëzimin e parë paralajmëron një ndalim të kthimit nga e majta 3. në kryqëzimin e dytë paralajmëron kthim nga e majta për të marrë drejtimin për në spital 4. në kryqëzimin e parë paralajmëron kthimin nga e djathta për në Gjirokastër 5. në kryqëzimin e dytë paralajmëron kthimin nga e djathta për të shkuar në Sarandë 6. tregon se për të shkuar në Kakavijë është e nevojshme të kthehem nga e majta në kryqëzimin e dytë 7. tregon dy kryqëzime qytetëse të njëpasnjëshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon ndërprerje të trafikut midis dy kryqëzimeve 2. paralajmëron ndalim kalimi në kryqëzimin e dytë 3. vendoset në një rrugë urbane (qytetëse) dhe tregon detyrimin për t'u kthyer vetëm djathtas 4. paraqet një kryqëzim interurban (ndërqytetës) në një rrugë me një sens

	lëvizje 5. shërben për të paralajmëruar trafikun në rrugët interurbane (ndërqytetëse) 6. tregon një pjesë të rrugës kryesore, që kryqëzohet me rrugë dytësore
--	---

168	
	
PARALAJMËRIM I NJË KRYQËZIMI URBAN ME RRETHQARKULLIM	
Pyetësori 35	Sinjali 168
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron kryqëzim urban (qytetës) me rrethqarkullim 2. paralajmëron që kthimi i parë djathtas është për të shkuar në Elbasan 3. paralajmëron që dalja e dytë djathtas është për të shkuar në Tiranë 4. tregon skemën e rrethqarkullimit 5. paraqet emrat e qendrave të banuara ku mund të shkojmë 6. është sinjal tregues qytetës paralajmërues
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një pjesë rruge që ka mbikalim 2. paralajmëron një zonë këmbësorësh 3. paralajmëron një zonë të përshtatur për park publik 4. tregon një rrethqarkullim pa dalje 5. është sinjal i parazgjedhjes urbane (qytetëse) me korsi kanalizimi

169	
	
PARALAJMËRIM I NJË KRYQËZIMI URBAN ME NDALIM QARKULLIMI PËR KATEGORI TË CAKTUAR MJETESH	
Pyetësori 36	Sinjali nr. 169
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron një kryqëzim urban (qytetës) me kufizim qarkullimi 2. ndalon mjetet e transportit të mallrave me peshe të plote mbi 3.5 tonë që të vazhdojnë lëvizjen drejt për në qytetin e Pogradecit 3. i lejon autoveturat të vazhdojnë lëvizjen drejt për në Prrenjas 4. paralajmëron që të kthehemi majtas në kryqëzimin urban (qytetës) për të hyrë në autostradë 5. paralajmëron një ndalim qarkullimi për mjetet e transportit të mallrave me ngarkesë të plotë mbi 3.5 tonë në drejtimin për në Pogradec 6. i lejon autobusët që të vazhdojnë drejt për në qendrën e Pogradecit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndalon qarkullimin për të gjitha llojet e automjeteve që të vazhdojnë drejt për në qendër të Pogradecit 2. paralajmëron një kryqëzim të rregulluar me rrethqarkullim 3. vendoset gjithmonë në karrexhatat me dy a më shumë korsi 4. është sinjal korsie që të lejon të zgjedhësh korsinë në funksion të drejtimit

5. tregon që korsia e mesit është e rezervuar vetëm për kamionët

170



PARALAJMËRIM I NJË KRYQËZIM INTERURBAN ME “KALIM NË NIVEL” TË PARUAJTURA NË NJË DEGË TË KRYQËZIMIT

Pyetësori 37

Sinjali nr. 170

Përgjigje të sakta

1. paralajmëron një kryqëzim rruge interurbane
2. tregon praninë e një “KALIMI NË NIVEL” në krahun e djathtë të kryqëzimit
3. paralajmëron që kthimi nga e majta është për në qendrën turistike të Vorës
4. paralajmëron se për të shkuar në Rinas, duhet të marrim drejtimin djathtas
5. tregon që në kthimin nga e djathta në kryqëzim jemi të paralajmëruar për një ndërprerje të rrugës me linjën hekurudhore

Përgjigje të gabuara

1. paralajmëron një mundësi parazgjedhje të trafikut në një kryqëzim urban
2. është sinjal i një kryqëzimi urban të vendosur mbi karrexhatë
3. tregon që stacioni hekurudhor arrihet duke marrë drejtimin djathtas
4. paralajmëron që zona industriale e Vorës është në të majtë të kryqëzimit
5. është një sinjal që tregon daljet nga autostrada Tiranë – Durrës

171



PARAZGJEDHJA INTERURBANE

Pyetësori 38

Sinjali nr.171


Përgjigje të sakta

1. është një sinjal parazgjedhjeje mbi rrugën interurbane të ndarë në dy korsitë për sens lëvizjeje
2. lejon zgjedhjen paraprake të drejtimit që do të marrë drejtuesi i mjetit
3. paralajmëron një zonë parazgjedhjeje me drejtime të ndryshme
4. i tregon drejtuesit të mjetit të drejtuar për në Shëngjin të marrë korsinë e majtë
5. i tregon drejtuesit të mjetit se për të shkuar në Shkodër, duhet të pozicionohet në korsinë e djathtë
6. tregon korsitë për t'u orientuara sipas destinacioneve(drejtimeve) përkatëse

Përgjigje të gabuara

1. është sinjal parazgjedhës për rrugët urbane
2. i vendosur në qendrat urbane, tregon korsinë e rezervuar për parakalim
3. është vendosur mbi karrexhatat urbane për ndarjen e rrymave të trafikut
4. tregon një degëzim autostradal
5. paralajmëron një kryqëzim urban (qytetës)

172


**PARAZGJEDHJA URBANE**


Pyetësori 39	Sinjali nr.172
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal parazgjedhje i vendosur në qendrat urbane (qytetëse) 2. në rrugët urbane (qytetëse) me shumë korsi lejon pozicionimin në korsitë e kanalizimit 3. zëvendëson sinjalin e paralajmërimit të kryqëzimit dhe tregon një parazgjedhje të kanalizimit urban 4. u tregon drejtuesve të mjeteve që shkojnë në Elbasan të pozicionohen në korsinë e majtë 5. lejon zgjedhjen paraprake të korsisë për të marrë drejtimin e dëshiruar 6. i tregon drejtuesit të mjetit që po lëviz drejt qendrës së qytetit, të pozicionohet në korsinë e djathtë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. parazgjedh trafikun në rrugët interurbane (ndërqytetëse) 2. i vendosur në rrugët interurbane (ndërqytetëse), tregon korsitë e rezervuara për parakalim 3. është vendosur në karrexhatat interurbane (ndërqytetëse) dhe ndan rrymat e trafikut 4. tregon një degëzim në autostradë 5. shërben për të kanalizuar trafikun në autostrada 6. paralajmëron një kryqëzim autostradal


173

**PARALAJMËRIM I DEGËZIMIT AUTOSTRADAL**


Pyetësori 40	Sinjali nr.173
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal që paralajmëron një degëzim 2. paralajmëron dy drejtime kryesore të lëvizjes 3. lejon zgjedhjen paraprake të drejtimit që duhet ndjekur 4. paralajmëron një degëzim nga e majta 5. është një sinjal i paralajmërimit autostradal 6. paralajmëron një degëzim në të cilin, për të shkuar në Durrës, duhet vazhduar lëvizja drejt
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal i korsisë urbane (qytetëse) 2. është vendosur mbi itinerare urbane (qytetëse) me intensitet të lartë trafiku 3. është një sinjal paralajmërimi i kryqëzimit urban (qytetës) 4. është i vendosur vetëm në rrugët dytësore 5. është sinjal i parazgjedhjes mbi rrugë interurbane (ndërqytetëse) kryesore


174	
	
PARALAJMËRIM I DEGEZIMIT URBAN	
Pyetësori 41	Sinjali nr.174
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal që paralajmëron kryqëzim 2. tregon dy drejtime kryesore të lëvizjes 3. lejon zgjedhjen paraprake të drejtimit që duhet ndjekur 4. paralajmëron një degëzim nga e djathta për të lëvizur për në qendrën e qytetit 5. është një sinjal i paralajmërimit urban 6. paralajmëron një degëzim në të cilin për të shkuar në Tiranë, duhet vazhduar lëvizja drejt
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal i korsisë në autostradë 2. i vendosur në fillim të qendrës urbane, paralajmëron detyrimin për të vazhduar lëvizjen drejt 3. paralajmëron fundin e sensit të dyfishtë për qarkullimin dhe fillimin e lëvizjes me një sens për qarkullimin 4. tregon kthimin nga e djathta për të shkuar në një qendër historiko-sportive

175	
	
SINJALET TREGUESE TË ITINERARIT	
Pyetësori 42	Sinjali nr. 175
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregues autostradal 2. paralajmëron se duke lëvizur sipas drejtimit të shigjetës, rruga të çon në Rinas 3. tregon se duke lëvizur sipas drejtimit të shigjetës, ndodhet rruga shtetërore interurbane që të çon në Durrës 4. tregon edhe numrin e identifikimit të rrugës interurbane për në Durrës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon distancën e aeroportit të Rinasit nga vendi ku është vendosur tabela 2. tregon se deri në Durrës duhet të përshkojmë edhe 35 km 3. paralajmëron se për të shkuar në Durrës duhet të kalojmë nga Rinas

176	
	
SINJAL PARALAJMERUES PËR URBAN	
Pyetësori 43	Sinjali nr. 176
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal që vendoset në qendra urbane (qytetëse)

	<ol style="list-style-type: none"> 2. tregon se për të shkuar në qendër të qytetit të Fierit, duhet vazhduar lëvizja drejt 3. tregon të vazhdohet lëvizja drejt për të arritur qendrën e qytetit të Fierit 4. i vendosur në rrugë me dy ose më shumë korsi, kryen edhe funksionin e sinjalit të korsisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal që vendoset në rrugë interurbane 2. paralajmëron se qyteti më i afërt është qyteti i Fierit 3. paralajmëron një rrugë jashtëqytetëse që të çon në Fier 4. vendoset vetëm në autostrada

177		SINJAL PARALAJMERUES PËR DREJTIME NË AUTOSTRADË
Pyetësi 44	Sinjali Nr. 177	
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregimi autostradal 2. i vendosur në një rrugë me dy ose më shumë korsi, kryen edhe funksionin e sinjalit të korsisë 3. tregon se për të shkuar në Rrogozhinë duhet të marrim autostradën A9 4. tregon se për të shkuar në Kavajë duhet të marrim autostradën A8 5. tregon sevendmbërritje është edhe Rinasi 	
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal që vendoset vetëm në rrugë urbane (qytetëse) 2. tregon se për të shkuar në Rrogozhinë duhen edhe 9 km 3. tregon se për të shkuar në Kavajë, fillimisht duhet të kalojmë nga Rinasi 4. është sinjal që vendoset 1 km para hyrjes në qytete 	

178		SINJAL TREGUES I DREJTIMIT NË RRUGËT INTERURBANE
Pyetësi 45	Sinjali nr. 178	
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregues në rrugët interurbane 2. është sinjal rrugor me funksion drejtimi 3. është sinjal që vendoset në një rrugë me dy ose më shumë korsi, i cili kryen edhe funksionin e sinjalit të korsisë 4. tregon se për të shkuar në Lushnjë duhet të vazhdojmë lëvizjen drejt 	
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. si rregull vendoset në rrugët urbane (qytetëse) 2. tregon se për të shkuar në Durrës duhet të kalojmë më parë nga qendra e qytetit të Lushnjës 3. tregon se për të shkuar në Lushnjë duhet të kalojmë më parë nga qendra e qytetit të Durrësit 	

179



SINJAL TREGUES I DREJTIMIT NË QYTET

Pyetësi 46	Sinjali nr. 179
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregues në rrugët urbane (qytetëse) 2. vendoset në një rrugë me dy ose më shumë korsë, i cili kryen edhe funksionin e sinjalit të korsisë 3. është sinjal tregues me funksion drejtimi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vendoset vetëm në rrugët interurbane (ndërqytetëse) 2. është një panel plotësues

180



SINJAL NË AUTOSTRADË ME KUFI ME TË VOGËL SHPEJTËSIE DHE PARALAJMËRIM DREJTIMI

Pyetësi 47	Sinjali nr. 180
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal me funksion drejtimi 2. tregon përdorim të veçantë të korsisë mbi të cilën është vendosur 3. vendoset në një rrugë me dy ose më shumë korsë, i cili kryen edhe funksionin e sinjalit të korsisë 4. tregon se shpejtësia minimale e detyrueshme në atë korsë është 90 km/orë 5. tregon se në atë korsë mund të lëvizim edhe me shpejtësi 100km/orë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon se në korsinë ku është vendosur, nuk lejohet të kalohet kufiri i shpejtësisë 90 km/orë 2. tregon se në korsinë ku është vendosur, detyron drejtuesit e mjeteve të lëvizin me shpejtësi më të vogël se 90 km/orë 3. tregon se në korsinë ku është vendosur lejohet kthimi i sensit të lëvizjes


181




SINJAL TREGUES RRUGE URBANE ME KUFI ME TË VOGËL TË SHPEJTËSISË


Pyetësi 48	Sinjali nr. 181
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kryen edhe funksionin e sinjalit të korsisë 2. tregon drejtimin i cili duhet ndjekur për të mbërritur në qendër të qytetit 3. tregon se shpejtësia minimale e detyrueshme është 60 km/orë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon distancën në km të qytetit, të treguar në sinjal nga vendi ku është vendosur sinjali


	<ol style="list-style-type: none"> 2. tregon se pas 60 km ndodhet qyteti i përshkuar në sinjal 3. tregon shpejtësinë maksimale me të cilën duhet të lëvizin mjetet në rrugën ku është vendosur sinjali
--	--

182 dalje LUSHNJË 	SINJALE TË ITINERARIT INTERURBAN
Pyetësori 49	Sinjali nr.182
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon itinerare interurbane të arritshme kur dalim nga rruga interurbane kryesore 2. vendoset para daljeve në rrugë interurbane kryesore 3. tregon që dalja për Lushnje është pas 500 metrash 4. tregon lokalitetet në të cilat shkohet duke përdorur këtë dalje 5. mbi sfondin ngjyrë kafe tregon lokalitete turistike 6. tregon distancën që ndan sinjalin nga një dalje e ardhshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron daljen nga qendra urbane (qytetëse) 2. vendoset në kufijtë e komunave 3. tregon qendrat e banuara që janë në distancën 500 metra mbas sinjalit 4. tregon lokalitetet ku arrihet duke vazhduar lëvizjen në autostradë 5. në hyrje të autostradave, paralajmëron degëzimet e ardhshme 6. tregon daljen nga kufiri territorial i bashkisë së Lushnjes

183 	FUNDI I QENDRËS SË BANUAR
Pyetësori 50	Sinjali nr.183
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fundin e një qendre të banuar 2. tregon, në rreshtin e parë të panelit blu, qendrën e parë të banuar dhe distancën 3. tregon fundin e qendrës së banuar dhe lokalitetet e ardhshme më të rëndësishme 4. në panelin blu tregohet distanca përkatëse kilometrike për çdo lokalitet 5. tregon fundin e kufirit të shpejtësisë prej 40 km/orë 6. tregon edhe fundin e ndalimit të përdorimit të sinjalizimit zanor 7. tregon se pas këtij sinjali hiqet kufizimi i sinjalizimeve zanore 8. vendoset në dalje të zonës së banuar 9. tregon lokalitetet në të cilat shkohet 10. tregon itinerare interurbane (jashtëqytetëse)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fillimin e një pjese rruge në ngjitje për të shkuar në një qytet malor 2. tregon një komunë ku rruga e hyrjes është e mbyllur 3. tregon një komunë të çmilitarizur pa depo armësh përreth 4. tregon se është një sinjal tregues në autostradë 5. para çdo dalje nga një rrugë interurbane kryesore, tregon lokalitetet ku mund të shkohet

	6. tregon lokalitetet që vijnë pas në distancë 500 m nga njëri tjetri 7. paralajmëron zgjerimin e rrugës në hyrje të autostradës 8. tregon fundin e ndalimit të qarkullimit për mjetet mbi 3,5 tonë 9. tregon rrugë të lirë për gjitha llojet e mjeteve mbi 3,5 tonë
--	---

184	
	
SINJAL TREGUES PËR AUTOSTRADË	
Pyetësori 51	Sinjali nr.184
Përgjigje të sakta	1. është sinjal vertikal tregues në autostradë 2. tregon distancat në kilometra për të arritur në qendrat e banuara përkatëse 3. vendoset në autostrada 4. tregon distancën faktike të qyteteve të arritshme 5. tregon distancën në km, për të arritur në qytetet e shënuara në sinjal 6. nëse sfondi i tij është blu, vendoset në rrugë interurbane (jashtëqytetëse)
Përgjigje të gabuara	1. paralajmëron lokalitetet e arritshme nga dalja tjetër autostradale 2. paralajmëron degëzimet autostradale me distancat përkatëse kilometrike 3. paralajmëron korsitë e kanalizimit 4. vendosur mbi korsitë autostradale tregon kilometrat e përshkuar nga lokalitetet e treguara 5. i vendosur në autostradë tregon distancën nga zonat e shërbimit 6. i vendosur mbi rrugët interurbane tregon degëzime autostradale 7. tregon lokalitetet e arritshme duke filluar nga hyrja e autostradës

185	
	
SINJALE TURISTIKE DHE TË TERRITORIT	
Pyetësori 52	Sinjali nr. 185
Përgjigje të sakta	1. B, C, E dhe D janë sinjale treguese turistike 2. është sinjal që tregon zonë turistike dhe territori 3. tregon se për të shkuar në portin turistik duhet lëvizur drejt 4. tregon se për të shkuar në zonën arkeologjike duhet të marrim drejtimin majtas 5. tregon se për të shkuar në det me pisha duhet të marrim drejtimin djathtas
Përgjigje të gabuara	1. vendoset vetëm në rrugët urbane 2. vendoset vetëm në stinën e verës 3. tregon se për të shkuar në zonën arkeologjike, fillimisht duhet të lëvizim drejt dhe pastaj të kthehemi majtas 4. tregon se për të shkuar në zonën e detit me pisha, fillimisht duhet të lëvizim drejt portit e pastaj të kthehemi djathtas

186



ZONË QYTETËSE PËR KËMBËSORË


Pyetësori 53	Sinjali nr.186
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fillimin e një zone të ndaluar për qarkullimin e mjeteve 2. nëpërmjet panelit, tregon kufizime të veçanta ose përjashtime 3. ka panelin që mund të lejojë qarkullimin e mjeteve për ngarkim - shkarkimin e mallrave 4. ka panelin që bën përjashtime për mjetet e personave invalidë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një zonë të banuar jashtë qytetëse 2. tregon një pistë të detyrueshme për kalimtarët 3. nëse është ndarë me vijë të tërthortë të kuqe, ndalon qarkullimin këmbësorëve 4. tregon rrugët për ekskursionë në zona turistike


187





ZONË ME TRAFIK TË KUFIZUAR


Pyetësori 54	Sinjali nr.187
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fillimin e një zone me trafik të kufizuar 2. tregon fillimin e një zone në të cilën qarkullimi mund të jetë i kufizuar në kohë 3. tregon fillimin e një zone ku trafiku është i kufizuar për kategori të veçanta mjetesh 4. në panelin plotësues tregon ndalimet dhe përjashtimet 5. në panelin plotësues tregon kategoritë e mjeteve të autorizuar për qarkullim
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron një zonë të rezervuar për kalimtarët 2. tregon një pistë për biçikleta 3. tregon që ndalohet kthimi i sensit të lëvizjes për mjetet e poshtë shënuara 4. është i vendosur në zona ushtarake ku s'mund të futesh (qarkullosh) 5. paralajmëron një zonë të pakalueshme në afërsi të një poligoni qitje

188		SINJAL TREGUES KALUESHMËRIE
Pyetësori 55	Sinjali nr. 188	
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal informues mbi gjendjen e rrugës 2. tregon për drejtuesit e mjeteve se rruga është e lirë 3. vendoset në fillim dhe përgjatë itinerarit në ngjitje në rrugët malore 4. mund të vendoset edhe në kryqëzimet e rrugëve 	
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal rreziku 2. vendoset vetëm në fillim dhe përgjatë itinerarit në zbritje të rrugëve malore 3. tregon se rruga është e zënë nga bora e madhe 4. vendoset vetëm në rrugët rurale 	


189		SINJAL TREGUES KALUESHMËRIE ME KUFIZIME
Pyetësori 56	Sinjali nr.189	
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon gjendjen e kalueshme në rrugët malore në dimër 2. përdoret kur është e nevojshme të vendosësh detyrime të kalueshmërisë mbi rrugë 3. tregon detyrime për lëvizje në itinerarin e treguar 4. tregon detyrim të vendosjes së zinxhirëve në gomë ose të vendosjes së gomave të borës për lëvizje 5. tregon që është e mundur mbërritja në Kukës 6. tregon që rruga mund të përshkohet me zinxhirë të montuar në goma 	
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon rrugën ku kalohet vetëm me mjete që kanë katër rrota me goma 2. tregon rrugën e hapur për kalimin e të gjitha mjeteve të papajisura me zinxhirë 3. tregon praninë e impianteve funksionale të hapura për ski 4. tregon një kalim të hapur pa mbrojtje anësore përgjatë karrexhatës 5. tregon që rruga e mbuluar me borë është e papajisur me treguese anësore për rrugët e malit 	


<p>190</p> 	<p>SINJAL TREGUES KALUESHMËRIE ME KUFIZIME</p>
<p>Pyetësori 57</p>	<p>Sinjali nr. 190</p>
<p>Përgjigje të sakta</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal informues mbi gjendjen e rrugës 2. tregon për drejtuesit e mjeteve se rruga është e lirë 3. vendoset në fillim dhe përgjatë itinerarit në ngjitje në rrugët malore 4. tregon se drejtuesit e mjeteve janë të rekomanduar të përdorin gomat e borës ose zinxhirët
<p>Përgjigje të gabuara</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal detyrimi 2. vendoset vetëm në fillim dhe përgjatë itinerarit në zbritje të rrugëve malore 3. lajmëron drejtuesit e mjeteve se nuk është nevoja të përdorin zinxhirët e borës 4. lajmëron drejtuesit e mjeteve se nuk është nevoja të përdorin gomat e borës

<p>191</p> 	<p>SINJAL TREGUES PAKALUESHMERIE</p>
<p>Pyetësori 58</p>	<p>Sinjali nr. 191</p>
<p>Përgjigje të sakta</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal informues mbi kalushmerinë e rrugës 2. tregon për drejtuesit e mjeteve se rruga është e mbyllur 3. tregon për drejtuesit e mjeteve se rruga është e pakalueshme
<p>Përgjigje të gabuara</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. lajmëron drejtuesit e mjeteve se rruga është zhbllokuar nga bora dhe mund të kalohet 2. vendoset për të lajmëruar drejtuesit e mjeteve që të heqin zinxhirët ose gomat e borës


<p>192</p> 	<p>SINJAL TREGUES PAKALUESHËMERIE OSE KALIM I MBYLLUR</p>
<p>Pyetësori 59</p>	<p>Sinjali nr. 192</p>
<p>Përgjigje të sakta</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal informues mbi kalushmerinë e rrugës 2. tregon për drejtuesit e mjeteve se rruga për në Kukës është e mbyllur 3. tregon për drejtuesit e mjeteve se rruga deri në Fushë Arrëz mund të kalohet, por vetëm me zinxhirë ose goma bore 4. tregon për drejtuesit e mjeteve se është i detyrueshëm përdorimi i gomave të

	borës ose zinxhirëve deri në Fushë Arrëz
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vendoset vetëm në pjesët drejtvizore të rrugës 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se kalimi i rrugës është i mundshëm edhe pa zinxhirë 3. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se kalimi i rrugës është i mundshëm edhe pa goma bore 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se rruga është e pakalueshme deri në Fushë Arrëz


193	
	RRUGË E PAKALUESHME OSE PJESËRISHT E PAKALUESHME
Pyetësori 60	Sinjali nr.193
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon kalueshmërinë në rrugët e malore 2. tregon që rruga është e pakalueshme kur në dy hapësirat e poshtme të tabelës nuk ka shënime 3. këshillon përdorimin e zinxhirëve ose gomave të borës deri në Fushë Arrëz 4. tregon se nuk mund të vazhdosh lëvizjen përtej lokalitetit të treguar në hapësirën e fundit të tabelës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ndalon të vazhdosh lëvizjen përtej pikës ku është vendosur sinjali 2. tregon që impiantet e skive nuk janë në funksion 3. tregon kalimin e mbyllur për gara automobilistike ose çiklistike 4. tregon që gjithë segmenti rrugor deri në Kukës është i hapur, mjafton që të montojmë zinxhirë në goma 5. kur shoqërohet me panel plotësues tregon lartësinë në centimetra të borës në vendet e skive 6. tregon se lejohet qarkullimi i mjeteve që transportojnë goma 7. tregon që rruga Kukës -Fushë Arrëz është me karrexhata të ndara

197	
	SINJAL PËR KUFIZIME TË PËRGJITHSHME TË SHPEJTËSISË
Pyetësori 61	Sinjali nr.197
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. vendoset në afërsi të kufijve kombëtare 2. tregon kufizimet e shpejtësisë të vendosura në rrugët e Republikës së Shqipërisë 3. në kuadratin e parë, tregon kufirin e shpejtësisë maksimale në qendrat e banuara

	<ol style="list-style-type: none"> 4. tregon se shpejtësia maksimale në rrugë interurbane dytesore në Shqipëri është 80 km/orë 5. tregon se shpejtësia maksimale në rrugët interurbane (jashtëqytetëse) kryesore në Shqipëri është 90 km/orë 6. tregon se shpejtësia maksimale në autostrada në Republikën e Shqipërisë është 110 km/orë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është vendosur në fillim të zonave industriale 2. tregon kufijtë e shpejtësisë për kamionët dhe autobusët 3. vendoset në hyrje dhe në dalje të qyteteve të mëdha 4. tregon një zonë industriale me kufizime të shpejtësisë 5. paralajmëron kalimin nga një autostradë në një qendër urbane 6. tregon një qytet që përshkohet nga një autostradë dhe një rrugë interurbane kryesore

<p>198</p>  <p style="text-align: center;">SINJALE TË DREJTIMIT INTERURBAN</p>	
Pyetësi 62	Sinjali nr. 198
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal drejtimi për rrugët interurbane (jashtëqytetëse) 2. ka një shifër e cila shpreh largësinë në kilometra deri te qendra e banuar 3. ka formë drejtkëndore me shigjetë në drejtim të qendrës së banuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal interurban rreziku 2. përmban një shifër e cila shpreh largësinë në metra nga një qendër e banuar 3. përmban elementë fosforeshentë për t'u dalluar nga një distancë e madhe

SINJALET E IDENTIFIKIMIT TË RRUGËS

<p>199</p>  <p style="text-align: center;">SINJALE TË IDENTIFIKIMIT TË ITINERARËVE NDËRKOMBËTARE</p>	
Pyetësi 63	Sinjali nr.199
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një itinerar ndërkombëtar European 2. tregon numrin e rrugës ndërkombëtare Europiane 3. vendoset në rrugë të rëndësisë ndërkombëtare Europiane 4. tregon autostradën ndërkombëtare Europiane në nr. 55 5. mund të përshihet në një sinjal paralajmërimi në një kryqëzim rruge
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. identifikon rrugët interurbane 2. tregon dalje ne autostradën nr. 55 3. tregon që duhen edhe 55 kilometra nga kufiri i një shteti me shtet tjetër 4. tregon një autostradë pa detyrimin për të paguar taksa 5. tregon kufirin ndërmjet shteteve 6. tregon që rruga ka stacione të furnizimit me benzinë ekologjike (jeshile)

200



SINJAL IDENTIFIKIMI AUTOSTRADAL

Pyetësi 64	Sinjali nr. 200
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal autostrade 2. mund të vendoset në një sinjal paralajmërimi të një kryqëzimi i cili të çon në autostradën nr.25 3. mund të vendoset në një sinjal të parazgjedhjes që të çon në autostradën nr.25 4. i plotësuar me shigjetë, tregon drejtimin për në një stacion hyrës të autostradës nr.25 5. është një sinjal i identifikimit autostradal 6. në këtë rast tregon autostradën nr. 25
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. identifikon një rrugë interurbane kryesore 2. tregon numrin e daljes së ardhshme nga autostrada 3. tregon distancën nga stacioni i ardhshëm autostradal 4. tregon një qendër të asistencës (shërbimi) në autostradë 5. gjatë autostradës tregon dhe kilometrat e përshkuara 6. tregon një itinerar ndërkombëtar

201



SINJAL IDENTIFIKIMI I RRUGËVE SHTETËRORE

Pyetësi 65	Sinjali nr. 201
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon numrin e rrugës që përshkohet 2. mund të plotësojë një sinjal të drejtimit 3. tregon se rruga në të cilën udhëtojmë është një rrugë shtetërore 4. tregon se po përshkojmë rrugën shtetërore Nr. 2
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon numrin e një rrugë fshati 2. tregon një rrugë të rrëshqitshme pas 2 kilometrash 3. tregon fundin e një rrugë ndërshtetërore 4. tregon një rrugë pa dalje pas 2 kilometrash 5. tregon një rrugë pa sinjalistikë rrugore përgjatë 2 kilometrave 6. tregon se qëndrimi është i ndaluar përgjatë 2 kilometrave

202



SINJAL IDENTIFIKIMI I RRUGËVE TË RRETHIT

Pyetësi 66	Sinjali nr. 202
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal i identifikimit të rrugës

	<ol style="list-style-type: none"> 2. është sinjal i identifikimit të rrugës interurbane të rrethit 3. tregon numrin e rrugës 4. tregon një rrugë rrethi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal i identifikimit të rrugëve urbane (qytetëse) 2. mban të shkruar një shifër e cila shpreh distancën në metra 3. tregon një udhëkryq të rregulluar me rrethrotullim 4. tregon distancën në kilometra nga Rrësheni

203



SINJALI I IDENTIFIKIMIT TË RRUGËVE KOMUNALE

Pyetësi 67	Sinjali Nr. 203
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të gjendet në fillim të një rruge komunale 2. mund të përdoret edhe për plotësimin e një sinjali drejtimi si në fig. 198 3. identifikoni një rrugë komunale 4. mund të gjendet gjatë rrugës komunale Nr.19
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon nëntëmbëdhjetë kilometra nga rajoni i policisë 2. tregon një karrexhatë me dy korsi për çdo sens lëvizje 3. tregon një rrugë me dy karrexhata të ndara 4. tregon fillimin e një zone ku qëndrimi është i lejuar

204



SINJALET E DISTANCËS PROGRESIVE

Pyetësi 68	Sinjali nr. 204
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal i kilometrazhit 2. tregon se shpreh distancën në kilometra nga fillimi i rrugës 3. tregon se jemi në kilometrin 24 të rrugës ku po lëvizim, distancë kjo e matur nga fillimi i rrugës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon numrin e identifikimit të rrugës 2. tregon se pas 24 metrash ka një dalje nga rruga 3. tregon se në vendin ku vendoset, lejohet pushimi i mjeteve gjatë gjithë kohës, pra 24 orë

205



SINJALET E DISTANCËS PROGRESIVE NE KM DHE

QINDMETËRSHE

Pyetësi nr. 69	Sinjali nr. 205
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal që tregon distancën në km dhe në m nga fillimi i rrugës 2. tregon distancën nga fillimi i rrugës në km dhe m 3. në pjesën e sipërme të vizës me shkronja romake tregon distancën 800 metra pas kilometrit 24 4. tregon se distanca nga fillimi i rrugës është 24 kilometra e 800 metra
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal rreziku 2. tregon se distanca e ardhshme deri në një qendër të banuar është 24 kilometra 3. është sinjal i tregimit autostradal

SINJALE TË INTENERARIT

206



LARGËSIMATËS PROGRESIV NË AUTOSTRADË

Pyetësi nr. 70	Sinjali nr. 206
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. në pjesën e djathtë tregon distancën për të arritur në qytetin e treguar 2. vendoset përgjatë një autostrade 3. nga e majta tregon distancën e përshkuar dhe nga e djathta distancën për të arritur në destinacionin e treguar 4. në pjesën e majtë tregon distancën e përshkuar, të matur nga hyrja në autostradë 5. tregon që duhen edhe 7 km për të mbërritur në destinacionin e treguar 6. është një sinjal tregues i largësive
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. në pjesën e majtë tregon një rrugë komune 2. në pjesën e majtë identifikon numrin e rrugës përkatëse 3. është një sinjal i drejtimit të detyruar në autostradë 4. në pjesën e djathtë shënon numrin e autostradës 5. tregon një lokalitet turistik 6. është një sinjal urdhërues detyrimi


207




FILLIMI I NJË QENDRE TË BANUAR

Pyetësi nr. 71	Sinjali nr. 207
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fillimin e një qendre urbane 2. është sinjal i vendosur në hyrje të një qendre të banuar 3. tregon se vlen edhe për të sinjalizuar drejtuesit e mjeteve se shpejtësia


	<p>maksimale me të cilën duhet të lëvizin pas këtij sinjali është 40 km/orë</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. vendoset në hyrje të një qendre të banuar, në të gjitha rrugët hyrëse të saj 5. u tregon drejtuesve të mjeteve se pas tij ndalohet përdorimi i sinjalit akustik (borisë)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fillimin e territorit të qarkut 2. i vendosur në udhëkryq tregon drejtimin që duhet të ndjekin drejtuesit e mjeteve për të arritur në Kukës 3. sinjalizon drejtuesit e mjeteve të përdorin sinjalin akustik (borinë) për të tërhequr vëmendjen e këmbësorëve 4. tregon drejtim të detyrueshëm për të arritur në Kukës


208	
	
FILLIMI I NJË RRETHI DHE FUNDI I RRETHIT TJETËR	
Pyetësi 72	Sinjali nr. 208
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal që tregon fillimin e një rrethi dhe mbarimin e rrethit tjetër. 2. vendoset në rrugët interurbane 3. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke hyrë në territorin e rrethit të Elbasanit 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke dalë nga territori i rrethit të Tiranës 5. tregon për drejtuesit e mjeteve se, nëse rruga është interurbane dytësore, shpejtësia maksimale e lëvizjes është 80 km/orë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon se është i ndaluar kalimi për në Tiranë për shkak të rrugës së bllokuar 2. është sinjal detyrimi 3. vendoset në qendrat urbane (të banuara) 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke dalë nga territori i rrethit të Elbasanit 5. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke hyrë në territorin e rrethit të Tiranës


209	
	
FILLIMI I NJË QENDËR ZONE TË BANUAR DHE FUNDI I NJË TJETRE	
Pyetësi 73	Sinjali nr. 209
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal që tregon fillimin e një komune dhe mbarimin e një tjetre 2. vendoset në rrugët interurbane 3. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke hyrë në territorin e komunës së Ndroqit 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke dalë nga territori i komunës së Pezës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke hyrë në territorin e komunës së Pezës

	<ol style="list-style-type: none"> 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se janë duke dalë nga territori i komunës së Ndroqit 3. është sinjal i fillimit dhe mbarimit autostradal 4. vendoset në hyrje të korsive të shpejtimit për në autostradë
--	--


SINJALE TË QENDRAVE TË BANUARA

<p>210</p>  <p style="text-align: center;">NDIHMA E SHPEJTË</p>	
Pyetësori 74	Sinjali nr. 210
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon hyrjen në një vend për ndihmë të shpejtë mjekësore 2. tregon drejtimin për të shkuar në një vend të ndihmës së shpejtë 3. vendoset pranë një vendi të ndihmës së shpejtë 4. vendoset afër një vendi të ndihmës së parë mjekësore
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një vend në kufi me Zvicrën 2. tregon një vend të ndërhyrjes së shpejtë 3. lokalizon një farmaci komunale 4. tregon rrugën që duhet ndjekur për në varreza 5. tregon një vend pushimi për autoambulanca 6. tregon një vend parkimi të rezervuar për personelin sanitar

<p>211</p>  <p style="text-align: center;">STACION TRENI</p>	
Pyetësori 75	Sinjali nr. 211
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vendtregues 2. tregon hyrjen në një stacion hekurudhor 3. tregon drejtimin për të hyrë në stacionin e hekurudhës 4. vendoset në distancë me vendndodhjen e një stacioni hekurudhor
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një vendpushim për lokomotivat e trenave 2. tregon rrugën që duhet të ndjekin drejtuesit e mjeteve për të arritur në varrezat publike 3. tregon një parkim të rezervuar për mjetet që do mbarten në tren 4. tregon një stacion treni në të cilin lejohet pushimi i mjeteve 24 orë


212	
	
POLICIA	
Pyetësi 76	Sinjali nr.212
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vendtregues 2. tregon hyrjen për në komisariatit e policisë 3. tregon me shigjetën e zezë drejtimin për në hyrjen e komisariatit të policisë 4. tregon se duke u kthyer djathtas, mbërrimë në organin e policisë të treguar në sinjal
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal rreziku 2. i vendosur në një kryqëzim tregon se kryqëzimi rregullohet nga punonjësi i policisë 3. i vendosur në një kryqëzim tregon se semafori është jashtë funksionit


214	
	
SPITAL	
Pyetësi 77	Sinjali nr. 214
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon hyrjen në spital 2. tregon vendndodhjen e një spitali 3. tregon drejtimin për të hyrë në një spital 4. është një sinjal i vendosur afër një qendre spitalore 5. është vendosur në prani të një spitali
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon se në afërsi ndodhet një studio mjekësore 2. tregon se në afërsi ndodhet një farmaci 3. tregon një parking të rezervuar për personelin sanitar

215	
	
POLICIA BASHKIAKE	
Pyetësi 78	Sinjali nr. 215
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vendtregues 2. tregon hyrjen për në institucionin e treguar në sinjal 3. me shigjetën e zezë tregon drejtimin për në stacionin e policisë bashkiake 4. tregon se duke u kthyer djathtas, mbërrimë në vendndodhjen e policisë bashkiake
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal i përkohshëm


	<ol style="list-style-type: none"> 2. sipas drejtimit të shigjetës na çon në stacionin metereologjik të qytetit 3. tregon se duke u kthyer djathtas, mbërrijmë në qendrën e rekrutimit të ushtarëve të rrethit 4. sinjalizon se sipas drejtimit të shigjetës lejohet të lëvizin vetëm mjete ushtarake
--	--


SINJALET TURISTIKE DHE TË TERRITORIT

216 	SINJAL I VENDOSUR PRANË NJË URE QE TREGON EMRIN E LUMIT
Pyetësori 79	Sinjali nr. 216
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. gjendet në afërsi të një lumi 2. tregon emrin e lumit në afërsi të një ure 3. është një sinjal tregues gjeografik 4. tregon që jemi afër një lumi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është i vendosur në një vend nën nivelin e detit 2. tregon që lumi është i pambrojtur nga prita 3. tregon një vijë uji që vërshon në rast shiu të madh 4. tregon një pjesë rruge, veçanërisht të rrëshqitshme në rast përmytjeje

217 	PARALAJMËRON PËR INFORMACION TURISTIK-HOTELIER
Pyetësori 80	Sinjali nr. 217
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një zyrë informacioni turistik-hotelierie e cila ndodhet pas 150 m 2. tregon mundësinë për të pasur informacione mbi hotele e motele 3. tregon një vend ku mund të kërkohen informacione mbi mundësitë e qëndrimit në hotele 4. është një sinjal tregues turistik
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të vendoset 150 metra nga një hotel 2. nënkupton të tregohet kujdes në afërsi të një moteli 3. është një sinjal i informacionit spitalor 4. fton drejtuesit e mjeteve të shmangin zhurmat në afërsi të një zone hotelierie

SINJALE TË TJERA QË JAPIN INFORMACION TË DOBISHËM PËR DREJTIMIN E MJETEVE

<p>219</p> 	
AUTOBUS PËR TRASPORT FËMIJËSH	
Pyetësori 81	Sinjali nr. 219
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. vendoset në anë të trotuarit dhe tregon vendqendrimin e një autobusi shkolle 2. vendoset në pjesën e jashtme të një autobusi, që përdoret për transportin e fëmijëve të shkollave 3. vendosur në anë të trotuarit, tregon stacion autobusi që transporton nxënës shkolle
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron një park lojërash për fëmijë 2. paralajmëron një vendkalim këmbësorësh të paruahtur 3. mund të paralajmërojë parqe publike 4. mund të paralajmërojë një shkollë fillore

<p>220</p> 	
SOS	
Pyetësori 82	Sinjali nr. 220
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një vënd të lajmërimit rrugor për ndihmë 2. është i vendosur në prani të një pajisje të lajmërimit rrugor për ndihmë 3. tregon një paisje për thirrjen e ndihmës në rrugë 4. tregon se mund të kërkosh ndihme për karburant, defekt ose rast sëmundje
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. fton drejtuesit e mjeteve të shmangin zhurmat në afërsi të një qendre të ndihmës mjekësore 2. sinjalizon ndalimin e qëndrimit të mjeteve gjatë 24 orëve të ditës 3. lokalizon një pajisje për ndërrimin e gomave, që është në funksion nga ora 8⁰⁰ deri në orën 20⁰⁰ 4. paralajmëron një pajisje të lëvizshme të ndihmës për të dëmtuarit 5. vendoset në afërsi të shkollave ku ka lëvizje fëmijësh 6. përdoret për të zëvendësuar trekëndëshin e lëvizshëm të rrezikut

221



NËNKALIM KËMBËSORËSH

Pyetësi 83	Sinjali nr. 221
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal që jep një informacion të dobishëm 2. tregon një nënkalim për këmbësorët 3. vendoset në anë të rrugës në fillim të nënkalimit 4. tregon se është nënkalim i rrugës vetëm për këmbësorët
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal rreziku 2. tregon një kalim të veçantë të rezervuar vetëm për invalidët 3. vendoset në brendësi të nënkalimit 4. mund të jetë edhe me fushë të bardhë 5. sinjalizon një mbikalim për këmbësorët

222



MBI KALIM KËMBËSORËSH

Pyetësi 84	Sinjali nr. 222
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një mbikalim për këmbësorët 2. vendoset në anë të rrugës në fillim të mbikalimit 3. tregon se është mbikalim i rrugës vetëm për këmbësorët
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. sinjalizon një nënkalim për këmbësorët 2. tregon një mbikalim të veçantë të rezervuar vetëm për invalidët 3. vendoset në brendësi të mbikalimit 4. sinjalizon një nënkalim për këmbësorët 5. mund të jetë me fushë me ngjyrë të bardhë


223




KALIM ME PJERRËSI PËR KËMBËSORËT

Pyetësi 85	Sinjali nr. 223
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një plan të pjerrët për kalimin e këmbësorëve 2. vendoset para fillimit të planit të pjerrët 3. vendoset në afërsi të vendndodhjes së planit të pjerrët për kalimin e këmbësorëve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. sinjalizon një plan të pjerrët për kalimin e ngarkesave të rënda në anën tjetër të rrugës

	<ol style="list-style-type: none"> 2. është sinjal rreziku 3. gjendet vetëm nga njëra anë e rrugës 4. të detyron të ndalosh lëvizjen për t'u dhënë përparësi mjeteve që dalin nga rrugë dytësore
--	---

224	
	
RRUGË PA DALJE	
Pyetësori 86	Sinjali nr. 224
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. vendoset në fillim të një rruge pa dalje për mjetet 2. lejon qarkullimin, por kalimi është pa rrugëdalje 3. tregon një rrugë pa dalje për mjetet
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal urdhërues i ndalimit 2. ndalon manovrat e kthimit të sensit dhe të lëvizjes prapa 3. ndalon kalimin e këmbësorëve 4. paralajmëron punime rrugore në fund të rrugës 5. ndalon kalimin e mjeteve me motor

225	
	
RRUGË PA DALJE	
Pyetësori 87	Sinjali nr. 225
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon ndërprerjen e një rruge me një rrugë tjetër pa dalje 2. lejon kthimin nga e djathta 3. lejon qëndrimin e mjeteve në rrugën nga e djathta 4. është një sinjal tregues
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndalon manovrat e kthimit të drejtimit në rrugën anësore 2. ndalon kalimin e këmbësorëve 3. paralajmëron një kryqëzim me një rrugë në të cilën është i ndaluar kalimi i mjeteve me motor 4. paralajmëron ndalim për t'u kthyer nga e djathta 5. tregon një rrugë të mbyllur për qarkullimin e mjeteve

230

**TUNEL**

Pyetësori 88	Sinjali nr. 230
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon që pushimi i mjeteve është i ndaluar në tunel 2. në rrugët interurbane është me ngjyrë blu 3. kujton që duhet të fiket motori në rast të ndalimit të zgjatur në tunel 4. tregon se është i ndaluar kthimi i sensit të lëvizjes brenda tunelit 5. tregon për drejtuesit e mjeteve që duhet të përdorë fenerët joverbues brenda në tunel 6. mund të shoqërohet edhe me një panel plotësues që tregon gjatësinë e tunelit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lejon qëndrimin e mjeteve, dhe në raste të veçanta, edhe pushimin e mjeteve 2. tregon që ndalohet kalimi në tunel prej punimeve në zhvillim 3. detyron mjetet për të përdorur sinjalizimet zanore brenda në tunel 4. ndalon lëvizjen e mjeteve në rreshta paralele 5. ndalon parakalimin midis mjeteve 6. lejon kthimin e sensit të lëvizjes, nëse tuneli është me dy sense qarkullimi

231

**URË**

Pyetësori 89	Sinjali nr. 231
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të tregojë fillimin e një mbikalimi 2. mund të jetë bashkërenduar me një panel plotësues që tregon gjatësinë 3. mund të tregojë fillimin e një ure 4. mund të tregojë fillimin e një ure-rrugë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon ndalimin e parakalimit midis automjeteve 2. mund të tregojë fillimin e një tuneli 3. tregon një kalim rrugor poshtë një ure 4. mund të tregojë një tunel në autostradë 5. nëse është me fushë të verdhë, tregon një urë me vlera turistike dhe kulturore 6. zëvendëson sinjalin e rrezikut nr.22 “URË E LËVIZSHME”

232

**ZONË ME BANESA**

Pyetësi 90	Sinjali nr. 232
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon fillimin e një zone urbane 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se duhet të ulin shpejtësinë e lëvizjes nën 40 km/orë 3. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se duhet të rrisin kujdesin 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se duhet të kenë kujdes në përdorimin e sinjaleve akustike .
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal urdhërues 2. tregon fillimin e një zone të gjelbër 3. tregon vendndodhjen e një kampingu 4. sinjalizon drejtuesit e mjeteve për përdorimin e sinjaleve akustike (borive) për shkak të lëvizjes së këmbësorëve

233

**FUNDI I ZONËS ME BANESA**

Pyetësi 91	Sinjali nr. 233
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal që jep informacion të dobishëm 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve “FUNDIN E ZONËS SË BANIMIT” 3. gjendet në dalje të zonave të banimit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal urdhërues 2. sinjalizon drejtuesit e mjeteve se në rrugën që vjen pas sinjalit, ndalohej të përdorin sinjalet akustike 3. gjendet vetëm në rrugët qytetëse 4. është sinjal që tregon drejtim të detyruar

237

**KTHIM GJYSËM I DREJTË MAJTAS**

Pyetësi 92	Sinjali nr. 237
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregues i dobishëm 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se në kryqëzimin e ardhshëm ndalohej kthimi majtas 3. i'u tregon drejtuesve të mjeteve që duan të kthehen majtas në kryqëzim, se duhet fillimisht të kthehen djathtas dhe me pas sipas intenerarit të treguar. 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve te cilët duan të kthehen majtas në

	<p>kryqëzimin që vjen, se duhet të ndjekin itinerarin e caktuar.</p> <p>5. gjendet në rrugët e zonave urbane (të banuara)</p>
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lajmëron drejtuesit e mjeteve se duhet të devijojnë drejtimin e lëvizjes për shkak të dëmtimeve të rrugës 2. vendoset vetëm në rrugët interurbane 3. sinjalizon drejtuesit e mjeteve se për t'u kthyer majtas kanë mundësi të kryejnë manovren e kthimit, menjëherë në kthesën pas tij. 4. paralajmëron drejtuesit e mjeteve se, pas shfaqjes së këtij sinjali para tyre, nuk janë të detyruar të kthehen djathtas 5. detyron drejtuesit e mjeteve që duan të kthehen majtas se kjo manovër është e mundur vetëm në kryqëzimin e ardhshëm

238



KTHIM JODIREKT (I TERTHORTË) MAJTAS

Pyetësori 93	Sinjali nr. 238
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon itinerarin e mundshëm për tu kthyer nga e majta 2. tregon që në këtë kryqëzim nuk është i mundur kthimi direkt majtas 3. tregon se lejon të vazhdosh drejt lëvizjen 4. ndalon kthimin majtas 5. tregon interes për drejtuesit e mjeteve që synojnë të kthehen majtas 6. është sinjal tregues i dobishëm për drejtuesit e mjeteve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. paraqet një detyrim për kthim nga e majta në kryqëzim 2. është i vlefshëm vetëm për automjetet 3. lejon ciklomotorët dhe motorët të kthehen menjëherë majtas në kryqëzim 4. është panel plotësues i vazhdimësisë 5. paraqet një seri kthesash të rrezikshme


239




NDRYSHIM I SENSIT TË LËVIZJES

Pyetësori 94	Sinjali nr. 239
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon praninë e një mbikalimi për ndryshimin e sensit të lëvizjes 2. tregon një nënkalim që lejon ndryshimin e sensit të lëvizjes 3. vendoset në një rrugë me karrexhata të ndara 4. tregon praninë e një strukturë (mbikalim ose nënkalim) që lejon të ndryshosh sensin e lëvizjes në një rrugë me karrexhata të ndara 5. ka sfond jeshil kur vendoset në autostrada
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal vertikal detyrimi 2. detyron kthimin e sensit të lëvizjes nga e majta 3. tregon që është i ndaluar vazhdimi i lëvizjes drejt sepse rruga në atë vend është e mbyllur 4. mund të shoqërohet edhe me panelin plotësues "URË"


	<ol style="list-style-type: none"> 5. është i vlefshëm vetëm për mjetet me motor 6. paralajmëron një kryqëzim të rrugës kryesore me një rrugë dytësore 7. mund të tregojë fillimin e një rruge interurbane kryesore 8. lejon ndryshimin e sensit të lëvizjes aty ku trafikndarësi është i ndërprerë (ka boshllëk)
--	---


	
VEND PËR QËNDRIMIN E MJETEVE	
Pyetësi 95	Sinjali i fig 240
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një vendqëndrim për mjetet në anë të karrexhatës 2. vendoset në afërsi të një vendqëndrimi për mjetet 3. tregon se lejon qëndrimin e mjeteve në vendqëndrimin e treguar 4. mund të jetë i bashkëshoqëruar me panelin plotësues, që tregon distancën në metra të vendqëndrimit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. paralajmëron një zgjerim të karrexhatës 2. shoqëruar me simbolin kryq i kuq, tregon praninë e një vendi të ndihmës së shpejtë 3. shoqëruar me simbolin “OFIÇINË RIPARIMI”, tregon praninë e një ofiçine për riparimin e automjeteve 4. tregon një stacion autobusi të shërbimit publik në autostrada 5. është i vendosur vetëm mbi autostrada 6. kur është me ngjyrë të verdhë, tregon një shmangie të rrugës për shkak të punimeve rrugore 7. është një sinjal i parazgjedhjes së korsive në rrugët interurbane kryesore 8. mund të shoqërohet edhe me sinjalin e rrezikut nr. 23 “BANKINA ME RREZIK SHEMBJE” 9. detyron mjetet të kthehen djathtas 10. kur është me sfond jeshil, tregon daljen më të afërt në autostrada

	
VEND PËR QËNDRIMIN E MJETEVE NË AUTOSTRADA	
Pyetësi 96	Sinjali nr. 241
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një sinjal autostrade 2. tregon një shesh (xhep) autostradal të pajisur me simbolin “SOS” që ka pajisje për telefonata emergjence 3. mund të jetë i shoqëruar me panel plotësues i cili tregon distancën e vendqëndrimit në metra 4. vendoset në afërsi të një sheshi (xhepi) në autostradë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. sinjalizon drejtuesit e mjeteve për një zgjerim të karrexhatës

	<ol style="list-style-type: none"> 2. ndeshet në rrugët interurbane dytësore 3. me një kryq të kuq sipër tregon një vend për dhënien e ndihmës së parë 4. me simbolin “NDIHMË MEKANIKE” tregon praninë e një ofiçine për riparimin e mjeteve
--	---

SINJALE QË TREGOJNË IMPIANTE DHE SHËRBIME.

252		ASISTENCË MEKANIKE
Pyetësi 97	Sinjali nr. 252	
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një ofiçinë për shërbime mekanike të mjeteve 2. tregon që në afërsi është një ofiçinë mekanike për mjetet 3. tregon mundësinë për të riparuar mjetin 4. tregon ndihmë teknike përgjatë një rruge interurbane 5. me fushe jeshile, vendoset përgjatë autostradës 	
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon punime riparuese në rrugë, kur sinjali është me fushë të verdhë 2. tregon një pikë vetëshërbimi për furnizimin me karburant 3. tregon në afërsi një zonë pushimi hotelerie 4. tregon telefon publik përgjatë një rruge interurbane 5. tregon fabrikë për prodhimin e veglave mekanike në afërsi të rrugës 6. tregon punëtorë të mirëmbajtjes së rrugëve në anë të karrexhatës 	

253		TELEFON
Pyetësi 98	Sinjali nr. 253	
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon se në afërsi ndodhet një telefon publik 2. tregon që jemi në afërsi të një vendi nga ku mund të telefonojmë 3. tregon mundësinë se në afërsi mund të telefonosh nga një telefon publik 4. tregon një aparat telefonik publik të vendosur në një rrugë interurbane (ndërqytetëse) 5. tregon një telefon publik në shërbim të drejtuesve të mjeteve 	
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon afrimin e një vendi ku është vendosur një central telefonik 2. tregon një vend të ndihmës së shpejtë 3. tregon një pjesë të rrugës me informacione mbi trafikun, që mund të merren me telefon 4. tregon një stacion autobusi për punonjësit e Postë - Telekomunikacionit 5. tregon që në atë zonë është i ndaluar komunikimi me telefon 6. tregon një pikë shitje për aparate telefonike në anë të rrugës 	

254



FURNIZIM KARBURANTI

Pyetësori 99	Sinjali nr. 254
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një vend furnizimi me karburant 2. tregon që në afërsi është një pikë furnizimi karburanti 3. informon drejtuesit e mjeteve që qarkullojnë në rrugët interurbane (ndërqytetëse) për praninë e një karburanti 4. me fushë jeshile, vendoset përgjatë autostradës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon në afërsi një ofiçinë për shërbime teknike 2. tregon një vend telefoni publik 3. tregon një vendqëndrimi për mjetet e transportit të mallrave të rrezikshme 4. tregon një zonë parkimi të autorizuar vetëm për mjetet çisterna të transportit të karburanteve 5. tregon një rafineri naftë

255



DISTRIBUTOR BENZINE

Pyetësori 100	Sinjali nr. 255
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon mundësinë e furnizimit me karburant në afërsi 2. tregon që është e mundur të furnizohesh edhe me benzinë pa plumb 3. ndeshet në rrugë interurbane (ndërqytetëse) 4. nëse është me sfond jeshil, tregon një impiant furnizimi me karburant në autostradë.
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një rafineri naftë në afërsi të rrugës 2. sinjalizon në afërsi një zonë qëndrimi për të riparuar mjetin 3. paraqet kufizim shpejtësie për mjetet gjatë qarkullimit në afërsi të një rafinerie naftë


256



STACION AUTOBUSI


Pyetësori 101	Sinjali nr. 256
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon vendqëndrimet e autobusëve të shërbimit publik interurban (ndërqytetës)


	<ol style="list-style-type: none"> 2. mund të këtë në pjesën e poshtme një panel me të dhëna për oraret e autobusëve interurbanë (ndërqytetës) 3. vendoset në prani të stacionit të qëndrimit të autobusit 4. vendosur përgjatë rrugëve urbane (qytetëse), tregon vendqëndrimet e autobusëve të linjave interurbane (ndërqytetëse) 5. tregon vendin ku mund të presësh një autobus të transportit publik interurban (ndërqytetës)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një korsi të rezervuar për autobusët interurbanë (ndërqytetës) 2. tregon një stacion të shërbimit dhe riparimit të autobusëve 3. tregon mundësinë për t'i telefonuar stacionit të autobusëve interurbanë (ndërqytetës) 4. tregon se në afërsi ndodhet një vend parkimi i autorizuar për autobusë 5. nëse është me ngjyrë jeshile, tregon një stacion autobusi në autostradë


<p>257</p> 	<p>STACION TRAMVAJI</p>
Pyetësori 102	Sinjali nr. 257
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon “VENDQENDRIM TRAMVAJI” 2. tregon vendqëndrim për tramvajet e transportit publik interurban (jashtëqytetës) 3. mund të shoqërohet me një panel plotësues qw tregon orarin e mbritjes 4. mund të shoqërohet me panel plotësues që tregon oraret e mbërritjes dhe nisjes së tramvajeve publikë interurbanë 5. mund të shoqërohet me panel plotësues, i cili tregon linjat përkatëse që përshkojnë tramvajet publikë të shërbimit interurban
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal autostradal 2. tregon një vend ndalimi për linjat e autobusëve publikë urbanë 3. tregon “NDALIM KALIMI” për tramvajet e shërbimit publik interurban 4. kur është me fushë jeshile, tregon korsinë e veçantë për autobusët interurbanë në autostradë

<p>258</p> 	<p>KAMP RINIE</p>
Pyetësori 103	Sinjali nr. 258
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon “HOTEL PËR TË RINJTË” 2. tregon një bujtinë ose hotel për turistët e moshave të reja 3. është sinjal tregues për shërbime hotelerie


Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon rrugë malore të bllokuar nga bora 2. është sinjal rreziku 3. tregon një qendër kurative me ujëra termale
----------------------	--


259	
	
ZONE PËR PIKNIK	
Pyetësori 104	Sinjali nr. 259
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregues që jep njoftiom për shërbime 2. tregon për drejtuesit e mjeteve se në afërsi ndodhet një “ZONË PIKNIKU” 3. tregon një hapësirë të pajisur me stola dhe tavolina ku përdoruesi i rrugës mund të pushojë dhe të hajë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal detyrues 2. detyron drejtuesit e mjeteve dhe përdoruesit e tjerë të rrugës që të bëjnë pushim dhe të hanë 3. tregon se në afërsi ndodhet një shkollë 9- vjeçare

260	
	
KAMPING	
Pyetësori 105	Sinjali nr. 260
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon afërsinë e një strukture të pajisur dhe të kompletuar për kamping 2. tregon zonë kampingu me tenda dhe vend qëndrimi për autokampet 3. është sinjal tregues i territorit turistik 4. vendoset në rrugë interurbane (jashtëqytetëse) por edhe urbane (qytetëse)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon rrugë të rezervuar për autokampet 2. tregon stacion qëndrimi të autobusëve në zonat turistike 3. tregon një pikë shitje për pajisje turistike 4. tregon një postë policie të përkohshme në një zonë turistike 5. tregon një qendër të ndihmës së shpejtë në afërsi të një zone turistike

261	
	
RADIO INFORMACION RRUGOR	
Pyetësori 106	Sinjali nr. 261
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal tregues shërbimesh 2. tregon për përdoruesit e rrugës për “RADIO INFORMACION RRUGOR”

	<ol style="list-style-type: none"> 3. tregon frekuencën e valëve të radios ku mund të merret informacion për qarkullimin rrugor 4. është i vendosur në autostrade
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal rreziku nga linjat e tensionit të lartë 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve të tregojnë kujdes të veçantë për arsye se në afërsi ndodhet një televizion lokal 3. sinjalizon drejtuesit e mjeteve të mos përdorin sinjalin akustik (boritë) pasi interferon(ndërhynë) në valët e radios

<p>262</p>  <p style="text-align: center;">MOTEL</p>	
Pyetësori 107	Sinjali nr. 262
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vendtregues shërbimi 2. vendoset në rrugët interurbane jashtë qendrave të banuara 3. nëse fusha është me ngjyrë jeshile, vendoset në autostrada 4. tregon për drejtuesit e mjeteve se në afërsi ndodhet një motel ose hotel
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i'u tregon përdoruesve të rrugës se në afërsi ndodhet një spital rajonal 2. sinjalizon se në afërsi ndodhet një qendër për dhënien e ndihmës së parë 3. nëse është me fushë me ngjyrë blu, vendoset në autostradë 4. është sinjal detyrimi 5. në autostrada haset në sheshpushimet për automjetet (xhepat)

<p>263</p>  <p style="text-align: center;">BAR KAFE</p>	
Pyetësori 108	Sinjali nr. 263
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vendtregues për shërbime 2. u tregon përdoruesve të rrugës se në afërsi ndodhet një bar-kafe 3. gjendet në rrugët interurbane (jashtë qendrave të banuara) 4. nëse është me fushë jeshile, vendoset përgjatë autostradave
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i'u tregon përdoruesve të rrugës se në afërsi ndodhet një spital për kurimin e të sëmurëve 2. sinjalizon se në afërsi ndodhet një qendër për dhënien e ndihmës së parë 3. nëse është me fushë me ngjyrë blu, vendoset në autostradë 4. detyron drejtuesit e mjeteve që kryejnë udhëtime të gjata të vendosin mjetet në parkim dhe detyrimisht të pushojnë një natë 5. vendoset në rrugët urbane

264

**RESTORANT**

Pyetësori 109	Sinjali nr. 264
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. u tregon përdoruesve të rrugës se në afërsi ndodhet një restorant 2. gjendet në rrugët interurbane (jashtë qendrave të banuara) 3. nëse është me fushë jeshile, vendoset përgjatë autostradave 4. është sinjal vendtregues për shërbime 5. mund të vendoset edhe në tabelat e sinjaleve që paralajmërojnë zona shërbimi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. sinjalizon se në afërsi ndodhet një qendër për dhënien e ndihmës së parë 2. i'u tregon përdoruesve të rrugës se shumë afër ndodhet një supermarket 3. detyron drejtuesit e mjeteve të parkojnë mjetin dhe të ushqehen në restorant 4. vendoset edhe në rrugët urbane 5. i'u kujton drejtuesve të mjeteve orarin për t'u ushqyer

268

**ZONË TURISTIKE NË KËMBË**


Pyetësori 110	Sinjali nr. 268
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vend tregues shërbimi turistik 2. u tregon drejtuesve të mjeteve se mund të parkojnë mjetet e tyre dhe të vazhdojnë lëvizjen në këmbë 3. tregon një vend parkimi për ekskursionistët të cilët dëshirojnë të vazhdojnë lëvizjen në këmbë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i'u tregon përdoruesve të mjeteve se rruga është e bllokuar nga bora 2. i'u tregon përdoruesve të mjeteve se duhet të vazhdojnë lëvizjen në këmbë për shkak të bllokimit të rrugës nga bora 3. vendoset vetëm në stinën e verës 4. tregon se rruga ndërpritet dhe këmbësorët duhet të ngjiten në mal nëpërmjet shkallëve


269

**AUTOMJETE MBI TREN**


Pyetësori 111	Sinjali nr. 269
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vend tregues për shërbime 2. vendoset në afërsi të stacioneve hekurudhorë


	<ol style="list-style-type: none"> 3. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se në afërsi ndodhet një stacion hekurudhor 4. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se stacioni hekurudhor që ndodhet afër, ofron shërbimin e transportit me tren të automjeteve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal rreziku 2. i'u tregon drejtuesve të mjeteve se shumë afër ndodhet një qendër për rimorkimin (tërheqjen) e mjeteve me avari 3. sinjalizon drejtuesit e mjeteve për afrimin e një mbikalimi 4. lajmëron përdoruesit e mjeteve se në afërsi ndodhet një “KALIM NË NIVEL”

<p>270</p>  <p style="text-align: center;">STACION HEKURUDHOR PËR TRANSPORTIN E MJETEVE</p>	
Pyetësori 112	Sinjali nr.270
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. gjendet në afërsi të një stacioni hekurudhor 2. tregon stacion hekurudhor që ofron shërbim për transport mjetesesh me tren dhe mundësi fjetje 3. tregon hyrjen për mjetet që do ngarkohen mbi tren
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon mundësinë të qëndrosh në makinë gjatë transportit të saj me tren 2. nëse është me ngjyrë jeshile, është vendosur gjatë autostradës 3. tregon një parking për vagonat hekurudhore me mjete 4. tregon një parking për autovetura rezervuar udhëtarëve

<p>271</p>  <p style="text-align: center;">NGARKIM MJETESH NË TRAGET</p>	
Pyetësori 113	Sinjali nr. 271
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është sinjal vendtregues shërbimi 2. tregon për drejtuesit e mjeteve se në afërsi ndodhet një port që ofron shërbime për transport mjetesesh 3. vendoset në afërsi të një porti 4. mund të vendoset përgjatë rrugës që të çon në port 5. tregon për drejtuesit e mjeteve molin ose pikat e ngarkimit të mjeteve në tragete ose anije 6. vendoset edhe brenda zonave portuale 7. i'u tregon drejtuesve të mjeteve orientimin drejt molit përkatës ose pikës së ngarkimit në varësi të vendit të mbërritjes 8. mund të shoqërohet me panel plotësues 9. mund të shoqërohet me panel plotësues në të cilin shkruhen informacione të tjera plotësuese për molin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i'u tregon drejtuesve të mjeteve që udhëtojnë drejt porteve për të imbarkuar

	<p>mjetet në tragete, se deti është shumë i trazuar</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. ndeshet vetëm në zonat e brendshme portuale 3. i'u jep drejtuesve të mjeteve informacion mbi oraret e mbërritjes së trageteve në portin shqiptar përkatës 4. shoqërohet me panel plotësues në të cilin gjejmë informacion mbi agjencinë e udhëtimit 5. shoqërohet me panel plotësues në të cilin gjejmë informacion mbi qytetin e nisjes së tragetit ose anijes
--	---

272	
	
TAKSI	
Pyetësori 114	Sinjali nr. 272 tregon
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. një vend qëndrimi për autovetura të shërbimit publik 2. një zonë qëndrimi vetëm për mjetet e shërbimit "TAKSI" 3. një zonë të kufizuar nga vija të verdha e plotësuar me shkrimin horizontal "TAKSI" 4. një zonë të përcaktuar për parkimin e mjeteve të shërbimit "TAKSI"
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon një korsi të rezervuar për lëvizjen e mjeteve "TAKSI" 2. tregon korsi të rezervuar për qarkullimin e taksive dhe autobusëve 3. tregon praninë në afërsi të një telefoni për thirrjen e shërbimit "TAKSI" 4. tregon që autovetura mbi të cilën është vendosur është e shërbimit publik

274	
	
POLICIA RRUGORE	
Pyetësori 115	Sinjali nr. 274
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon vendin dhe numrin e telefonit të postës më të afërt të policisë rrugore 2. tregon adresën dhe numrin e telefonit të policisë rrugore më të afërt 3. tregon të dhënat e nevojshme për postën e policisë rrugore më të afërt 4. tregon të dhëna të nevojshme për të komunikuar me postën më të afërt të policisë rrugore
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon rrugë të bllokuar për shkak të një aksidenti rrugor 2. tregon vendin dhe numrin e telefonit të komandës ushtarake më të afërt 3. tregon adresën e komandës së forcave ushtarake të atij rajoni 4. tregon një postbllok të policisë



QENDRA E NJË QYTETI OSE QENDËR BANIMI

Pyetësi 116	Sinjali Nr. 306
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. sinjalizon “QENDËR” e një qyteti ose qendër banimi 2. vendoset bashkë me sinjalet treguese 3. shoqëron sinjalet treguese që tregojnë qendrën e një zone të banuar
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon se në afërsi ndodhet një poligon për qitje 2. sinjalizon se shumë afër ndodhet një pallat sporti për lojra olimpike 3. është sinjal urdhërues

HARTAT RRUGORE DHE PËRDORIMI I TYRE

Pyetësi 117	Hartat rrugore,
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. i shërbejnë drejtuesve të mjeteve që udhëtojnë në rrugë të panjohura 2. kanë objekt kryesor të paraqesin rrugët automobilistike si dhe qendrat e banuara 3. paraqesin edhe detet, liqenet, etj., për të orientuar drejtuesit e mjeteve
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kanë objekt kryesor të paraqesin vetëm qendrat e banuara 2. janë të ndërtuar me shkallë zmadhimi 3. paraqesin vetëm detet dhe liqenet

Pyetësi 118	Në hartat rrugore,
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. pjesa e poshtme tregon jugun 2. rrugët interurbane shënohen zakonisht me ngjyrë të kuqe 3. rrugët interurbane kryesore dhe autostradat shënohen me dy vija paralele
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. rrugët interurbane kryesore shënohen me ngjyrë të zezë 2. pjesa e poshtme tregon veriu 3. pjesa e majtë tregon lindjen

Pyetësi 119	Kur për të vajtur në vendin e caktuar është e nevojshme harta rrugore, drejtuesi i mjetit taksi, duhet
<i>Përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ketë me vete hartën e rajonit ku do të bëhet udhëtimi 2. të përcaktojë në hartë rrugën që do të ndjekë deri në vendmbërritje 3. të përcaktojë vendet e pushimeve të detyruara që do të bëhen (për rastet e udhëtimeve të gjata)
<i>Përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përcaktojë qendrat tregtare që gjenden gjatë rrugës 2. të përcaktojë vetëm emrat e qendrave të banuara, që do të kalojë 3. të përcaktojë vetëm vendin e mbërritjes në hartë

KAPITULLI III

MËNYRA E VEPRIMIT NË RAST AKSIDENTI

Pyetësori 120	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të kërkojë ndërhyrjen e organeve të Policisë Rrugore për të kqyrur rrethanat është e nevojshme, nëse ka të plagosur 2. duhet të mbajë shënim gjeneralitet e drejtuesit tjetër, të dhënat e lejes së drejtimit, të qarkullimit dhe të sigurimit 3. duhet të nxjerrë të gjithë elementet e dobishme për rindërtimin e dinamikës së saktë të aksidentit 4. duhet të shmangë modifikimin apo deformimin e gjurmëve, në rast se duhet rindërtuar dinamika e aksidentit, 5. mund të përdorë formularin e konstatimit miqësor të ngjarjes për denoncimin tek shoqëria siguruese
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nëse është në faj duhet të marrë gjeneralitet e drejtuesit tjetër dhe nëse ka të drejtë kjo nuk është e nevojshme 2. mjafton që të kujtojë pozicionin e saktë të automjeteve pas përplasjes 3. nëse ndërhyr autoriteti policor, duhet vetëm të ngulë këmbë që të shkruhet versioni i tij për aksidentin 4. nëse ka dëme vetëm në sende, duhet vetëm të marrë numrin e targës së mjetit

Pyetësori 121	Pas një aksidenti rrugor, që nuk përbën vepr penale duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vendoset trekëndëshi i rrezikut, si në rastet e parashikuara nga Kodi Rrugor 2. që mjeti të largohet sa më shpejt kur është e mundur, duke e zhvendosur jashtë karrexhatës 3. të vendoset automjeti, nëse është e mundur, të paktën përgjatë anës së djathtë të karrexhatës 4. që në pa mundësi të zhvendosë automjetin, të mundësojë orientimin e qarkullimit të mjeteve tjera deri në mbërritjen e organeve të Policisë 5. të njoftohen organet përkatëse, në pamundësi të zhvendosjes së mjetit, dhe ti presim në vendin e ngjarjes
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vendoset “ trekëndëshi i rrezikut” në anën e prapme të automjetit, përpara se të largoheni 2. të mbulohet mjeti me një mbulësë plastike 3. vetëm nëse është natë, duhet të vendoset trekëndëshi i rrezikut në afërsi të automjetit 4. të vendoset menjëherë automjeti mbi trotuar 5. që në çdo rast, të paraqesësh denoncimin në komisariatit e policisë më të afërt 6. që automjeti i ndaluar, të mos sinjalizohet me “trekëndësh rreziku”

Pyetësori 122	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. jashtë qendrave të banuara, duke vendosur trekëndëshin e rrezikut pas automjetit të ndaluar, nëse bllokohet karrexhata

	<ol style="list-style-type: none"> 2. edhe me sinjale me duar që kanë qëllim të pengojnë kalimin në zonën e rrezikshme 3. kur kemi rrjedhje të substancave të rrëshqitshme mbi karrexhatë 4. menjëherë në rast bllokimi të karrexhatës, veçanërisht nëse ka ndodhur në kthesë 5. për të mbrojtur një të plagosur që nuk mund të lëvizet nga rruga 6. atëherë kur mbeten në karrexhatë pjesë të automjeteve të aksidentuara që pengojnë qarkullimin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vetëm në rast se trafiku është i bllokuar për shkak të tij 2. vetëm në rast se ai ka ndodhur në rrugë interurbane pa ndriçim 3. duke i rënë pajisjes së sinjalizimit zanor me bori me intervale të rregullta kohe 4. duke ndezur një zjarr në afërsi të automjetit të aksidentuar, nëse është errësirë 5. vetëm në rast se ai ka ndodhur natën, në një qendër të banuar të ndriçuar

Pyetësi 123	Gjetja e dëshmitarëve në rast aksidenti rrugor,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e nevojshme nëse përdoret formulari i konstatimit miqësor 2. mund të bëhet me një deklaratë të shkruar nga ana e të pranishmëve 3. është e dobishme, edhe nëse bëhet fjalë për pasagjerë të transportuar 4. bëhet duke pyetur personat e pranishëm gjatë përplasjes, nëse janë të gatshëm të dëshmojnë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e dobishme vetëm nëse sigurimit të njërit prej drejtuesve i ka kaluar afati i vlefshmërisë 2. është e nevojshme vetëm në rast aksidentesh me të plagosur 3. nuk është e nevojshme nëse mendon që ke të drejtë 4. nuk duhet nëse përgjegjësia e aksidentit është e drejtuesit tjetër 5. duhet vetëm nëse drejtuesi i mjetit tjetër është dukshëm një person pak i besueshëm

Pyetësi 124	Për të përcaktuar personat ose/edhe automjetet e përfshirë në një aksident rrugor
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të kontrollohet leja e qarkullimit për t'u siguruar në pronësi të kujt është mjeti 2. duhet të kontrollohet edhe leja e drejtimit për të siguruar identitetin e drejtuesit të mjetit 3. duhet të kontrollohet edhe çertifikata e sigurimit dhe të merren të dhënat e saj 4. duhet të kontrollohen dokumentet e të gjithë drejtuesve të mjeteve që janë përfshirë në aksident 5. duhet shënuar targa dhe tipi i mjetit, nëse ky nuk ndalon në vendngjarje
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e mjaftueshme të kërkohen vetem gjeneralitetet e drejtuesit të mjetit 2. mjafton t'i japim kartvizitën tonë, për të identifikuar drejtuesin e mjetit 3. duhet të kontrollojmë gjithmonë numrin e shasisë, për të identifikuar mjetin 4. duhet ta mbajmë gjithmonë, edhe forcërisht personin përgjegjës derisa të vijmë autoritetet policore 5. është e mjaftueshme ta bësh të lëshojë një deklaratë se si ka ndodhur ngjarja

Pyetësi 125	Të ndihmsh një të aksidentuar në rrugë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e detyrim ligjor dhe moral 2. është detyrimi i Kodi Penal i cili dënon mosdhënien e ndihmës 3. është e detyrueshme, sepse ndihma mund të kufizojë pasojat negative të aksidenti 4. duhet të jesh i qetë dhe i saktë në veprimet që kryhen 5. duhet të mos nxitohesh dhe të mos vesh edhe jetën tende në rrezik
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e detyrueshme 2. është e detyrim vetëm nëse gjykohet aksident i rëndë 3. nuk është detyrim nëse do ti shmangesh përfshirjes në ngjarje 4. është i detyrim vetëm për mjekët dhe personelin sanitar

Pyetësi 126	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vlerësojë situatën me qëllim që të mbrojë të dëmtuarin nga rreziqe të tjera 2. të ndihmojë të dëmtuarin sa më mirë të mundet, pa ndërmarrë inisiativa që i takojnë organeve kompetente mjekësore 3. të sigurojë dhe sinjalizojë sa më mirë zonën e aksidentit 4. të kryejë veprime të ndihmës sipas mundësive dhe njohurive të tija të fituara në kurset e parashikuara me ligj 5. që të vendosë në kontroll emocionet e tija, para fillimit të veprimeve 6. ti ofrojë të aksidentuarit mbështetje emocionale
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të largohet nga vendi i aksidentit, pas dhënies së saj 2. të distancohet dhe të presë ndihmë pa bërë asgjë 3. të identifikojë të dëmtuarin, para se t'ia japë atë 4. t'i japë medikamente edhe pa pasur kompetencën e duhur, nëse e shikon të arsyeshme

Pyetësi 127	Qëllimi i ndihmës së parë është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të marrë masa të thjeshta dhe të shpejta për mbijetesën e të aksidentuarit 2. të ndihmojë të dëmtuarin, sa më mirë të jetë e mundur, në pritje të ndihmës mjekësore 3. të shmangë, me sa ka mundësi, që i dëmtuari të lëndohet përsëri 4. të shmangë çdo ndërhyrje të gabuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vendosë të dëmtuarin në pozicion me të rehatshëm 2. të informohemi nga viktimi për rrethanat e aksidentit për t'i referuar autoriteteve kompetente 3. të largojë në çdo rast të dëmtuarin nga vendi i aksidentit 4. të pengojë çdo ndërhyrje për të favorizuar punën e policisë

Pyetësi 128	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me gjak, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mbulohet ajo me material të pastër dhe të shtrëngohet, për të bllokuar rrjedhjen e gjakut 2. të lahet me ujë nëse plaga është ndotur me dhera 3. të mos lëvizet trupa të huaj të mundshëm të pranishëm në të 4. të bllokohet rrjedhja e gjakut me garzë sterile ose me copë të pastër 5. të mbahet i dëmtuari në pozicion ulur ose shtrirë 6. që në rast hemoragjije të jashtme, të bllokohet ajo dhe të thirret menjëherë ndihma e shpejtë

	<ol style="list-style-type: none"> 7. të ruhet në maksimum nga rreziku i infeksionit 8. të ruhemi nga kontakti i drejtpërdrejtë me gjakun
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të nxirren menjëherë trupa të huaj të pranishëm në të, pastaj të mbulohet 2. t'i jepet atij të pijë ujë ose çaj nëse është pa ndjenja 3. të mos mbulohet plaga për të lehtësuar mpiksjen spontane të gjakut 4. të manipulohet plaga në mënyrë që të zvogëlohet dalja e gjakut 5. që në rast hemoragjie të jashtëme, të bësh që të ecë i dëmtuari, për të shmangur shfaqjen e gjendjes së shokut

Pyetësi 129	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. që me kujdes të lidhet ai pa e nxjerrë trupin e huaj 2. të ndalohet që i dëmtuari të prekë syrin e plagosur, për të shmangur dëmtime më të rënda 3. të lidhet ai dhe të ndalohet që të preket deri në ndërhyrjen e një specialisti 4. që trupi i huaj të hiqet vetëm nga një mjek specialist
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të bëhet përpjekje për të nxjerrë trupin e huaj për të shmangur infeksionet 2. të masazhohet ngadalë ai për të favorizuar lotimin 3. të mos lidhet ai absolutisht 4. të hidhet ujë në të për të mundësuar daljen e tij

Pyetësi 130	Shenjat e fillimit të gjëndjes së shokut janë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. lëkura e ftohtë me ngjyrë shumë të zbehtë 2. djersë të ftohta në ballë dhe gjendje e tensionuar 3. të dridhura trupore 4. zbehtësi, djersë të ftohta, gjendje e tensionuar, rrahje të zemrës të dobëta por të shpeshta
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. shfaqja e njollave mbi lëkurë 2. shfaqja e ngjyrës së kuqe të lëkurës, që tregon rritje të temperaturës 3. rrahje të forta të zemrës dhe tension i lartë

Pyetësi 131	Kur i dëmtuari paraqet gjëndje shoku duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të shtrihet në tokë, të mbulohet dhe të mbahen të ngritura gjymtyrët e poshtme 2. të mbulohet sa më mirë të jetë e mundur 3. të shtrihet me gjymtyrët e poshtme të ngritura nga trupi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ngrihet për të ecur që të riaktivizohet qarkullimi i gjakut 2. të vendoset në pozicion ulur 3. të goditet me kujdes në fytyrë dhe gjymtyrë për të riaktivizuar qarkullimin e gjakut 4. t'i jepen sasi të vogla pije alkoolike

Pyetësi 132	Nëse viktimi e një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të shihet nëse merr frymë duke i vënë dorën në pjesën anësore të poshtme të gjoksit, ose mbi bark 2. nëse merr frymë vetë, të vendoset në pozicionin anësor të sigurisë 3. nëse nuk merr frymë, t'i lirohet goja edhe hunda nga pengesa të mundshme 4. të kujdesesh për gjendjen e tij deri në mbërritjen e ambulancës

Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të bësh të ecë e të flasë me të dëmtuarin për ta mbajtur zgjuar 2. të bësh që të mos mundet të lëvizë fare trupin 3. të fashosh dhe të bësh që të mos mundet të lëvizë koken 4. të pyetet nëse ka dhembje në kokë
----------------------	---

Pyetësi 133	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të njoftojhet për ndihmë shërbimi i energjencë 2. nëse e është e nevojshme, t'i lehtësoi frymëmarrjen duke e vendosur të dëmtuarin gjysmëulur 3. që në se ka plagë të dukshme dhe të thellë, të shtypet menjëherë me një copë të pastër 4. të ruhet me kujdes deri në mbërritjen e ndihmës parë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. ta ndihmosh të bëjë frymëmarrje të thella 2. të vendoset i plagosuri në pozicion shtrirë 3. në rast plage të thellë, të pastrohet, dizinfektohet dhe të mjekohet plaga 4. të vendoset i dëmtuari në pozicion drejt për të kufizuar daljen egjakut

Pyetësi 134	Nëse i dëmtuari paraqet një ose më shumë fraktura në gjymtyrë, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos lëvizet gjymtyra e thyer para se të bëhet e palëvizshme 2. të bëhet e palëvizshme me mjete të rastit gjymtyra e thyer pa vazhduar me manovra të tjera 3. të mbulohen me material të pastër plagët e mundshme të shkaktuara nga thyerjet 4. pasi të bëhet e palëvizshme gjymtyra e dëmtuar, të merren masat parandaluese kundër gjendjes së shokut nëse është e nevojshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përpiqesh të rregullosh thyerjen për të pakësuar dhimbjet 2. të nxitet i dëmtuari të lëvizë gjymtyren e thyer për të vlerësuar dëmtimet 3. në rast të thyerjes së kockës, dhe kocka ka dalë jashtë, të përpiqesh ta rivendosësh përsëri në pozicionin e saj normal 4. t'i jepet të plagosurit një pije e fortë alkoolike

Pyetësi 135	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe viktimë paraqet djegie, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të shuhet flakët me batanije ose materiale të tjera të ngjashme 2. të mos hiqen mbetje të mundshme të veshjeve të ngjitura në pjesët e djegura 3. që nëse djegia i përket gjymtyrëve, kur është e mundur të futen ato në ujë të ftohtë për të lehtësuar dhimbjen 4. që nëse djegiet përfshijnë trupin, të mbulohen me material të mundshëm steril (të pastër)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. që nëse ka akoma mbetje të flakëve, të pritët që të shuhet pastaj të ndërhyhet 2. të hiqen gjithë mbetutinat e veshjeve të djegura në pjesët e dëmtuara 3. të dizinfektohen djegiet me alkool 4. vetëm të njoftojme shërbimin zjarrfikës dhe të presim

Pyetësi 136	Gjendja e shokut
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të shkaktohet nga një dhembje e fortë

	<ol style="list-style-type: none"> 2. mund të shkaktohet nga një emocion i fortë 3. mund të shkaktohet nga një humbje gjaku e madhe 4. mund të shkaktohet edhe nga një traumë e fortë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk shfaqet kurrë në rastet e emocioneve të forta 2. nuk mund të shkaktohet në raste traumash 3. nuk shoqëron humbjet e mëdha të gjakut 4. nuk paraqet rrezik të madh për shëndetin

SANKSIONET ADMINISTRATIVE NDAJ DREJTUESEVE TË MJETEVE TAKSI

Pyetësi 137	Cilido që kryen shërbim ‘taksi’, përveç masave plotësuese, ndëshkohet edhe me gjobë
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur kryen transport udhëtarësh me mjete që nuk janë prodhuar për transport udhëtarësh 2. kur transporton udhëtarë me mjete me (4+1) vende që kanë më pak se katër dyer 3. kur transporton udhëtarë me mjete me (8+1) vende që kanë më pak se tre dyer 4. kur transporton udhëtarë në një mjet të pa paisur me taksimeter 5. kur transporton udhëtarë në linjë të rregullt ndërqytetëse 6. kur merr në kthim, udhëtar në një rreth tjetër 7. kur aplikon tarifa me te vogla se tarifat dysHEME te miratuara
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur transporton udhëtarë me mjete me (4+1) vende që kanë më shumë se katër dyer 2. kur transporton udhëtarë me mjete me (8+1) vende që kanë më shumë se tre dyer 3. kur transporton udhëtarë në një mjet të paisur me taksimeter

Pyetësi 138	Liçenca për shërbimin taksi, pezullohet
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur kryen transport në linje të rregullt qytetëse 2. kur kryen transport në linje të rregullt ndërqytetëse 3. kur stacionohet në stacionet e linjave të autobusëve qytetës 4. kur stacionohet në stacionet e linjave të autobusëve ndërqytetës 5. kur merr në kthim, udhëtar në një rreth tjetër 6. kur aplikon tarifa me te vogla se tarifat dysHEME te miratuara
<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. në stacionimin e taksive, nuk e vendos mjetin në radhë 2. është i pari ose i dyti në radhë, në stacionim, dhe nuk qëndron brenda në mjet 3. kur drejtuesi i mjetit pin duhan gjatë drejtimit të mjetit 4. nuk ndihmon udhëtarët, për sistemimin e bagazheve

Pyetësi 139	Leja e qarkullimit të mjetit taksi, pezullohet,
<i>përgjigje të sakta</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur mjeti, nuk është prodhim origjinal, për transport udhëtarësh 2. kur mjeti me (4+1) vende ka më pak se katër dyer 3. kur mjeti nuk është i pajisur me taksimeter 4. kur mjeti taksi me (8+1) vende ka më pak se tre dyer

<i>përgjigje të gabuara</i>	<ol style="list-style-type: none">1. kur nuk shërben në rrugën më të shkurtër2. kur gjatë ndalimit, drejtuesi ndërpret funksionimin e taksimetrit3. kur gjatë furnizimit me karburant, drejtuesi ndërpret funksionimin e taksimetrit4. kur transporton dy fëmijë nën 10 vjeç, mbi numrin e vendeve.
-----------------------------	--

Grupi i punës

1. Kryetari: Demir Osmani
2. Anëtar: Gjon Kola
3. Anëtar: Ilir Gjelishti

Data 25.03.2014